



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 683 Akti

Nr. 618 Vendimi

Tiranë, më 1.2.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Suela Zhegu	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, në datën 1.2.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Suela Beluli**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Suela Beluli, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Roland Ilia kryesues dhe Genta Tafa (Bungo) anëtare. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisioneri Roland Ilia. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Willem Brouwer.

3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e pasurive;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*

¹Shkresë nr. *** prot., datë 30.3.2018.

- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit *Suela Beluli*.

7. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 11.1.2023, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit *Suela Beluli* dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet paraprake të hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10. Për një proces të rregullt ligjor, znj. *Suela Beluli* i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; si dhe (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen e hetimit dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe u njoh me rezultatet paraprake të hetimit administrativ.

11. Znj. *Suela Beluli*, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datën 25.1.2023. Subjekti i rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

²Me shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2022, është dërguar raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin me nr. *** , datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 23.9.2022, të KDZH-së.

³Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2022.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 26.1.2023.

13. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 30.1.2023, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer.

14. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit Suela Beluli ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Znj. Suela Beluli ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

18. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një

proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- g. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Suela Beluli, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, u krye mbi bazën e tri kriterëve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

23. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, si dhe mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.

24. Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga znj. Suela Beluli në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në datën 23.1.2017, në zbatim të ligjit, ku subjekti ka deklaruar:

25. Njësi⁴ me sip. 36.7 m², në Elbasan. Vlera e deklaruar në shumën 1.900.000 lekë. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar kredi në “Raiffeisen Bank”, shuma 1.560.000 lekë, marrë në datën 18.8.2005 dhe kursime nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit.

⁴Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetim nga dokumentet hipotekore të ZVRPP-së Elbasan, ku sipas regjistrimit hipotekor nr. ***, datë 27.12.2007, figuron e regjistruar në pronësi të shtetases Suela Beluli pasuria nr. ***-N**, lloji “njësi”, me sip. 36.7 m², ndodhur në z. k. ***, lagjja “5 M”, Elbasan; kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme) nr. ***, datë 27.12.2007, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Z. A.T, S.T, M.T, S.T dhe palës blerëse Suela Beluli. Pala shitëse deklaroi se janë bashkëpronarë mbi pasurinë e paluajtshme “njësi”, me sip. 36.7 m², pronë e cila ndodhet në lagjen “5 M”, pallati nr. **, Elbasan, regjistruar me nr. ***-N**, sipas dokumentit hipotekor ***, datë 7.5.2007. Shitësit deklarojnë

Hetimi i Komisionit

26. ASHK Elbasan⁵ ka konfirmuar se në emër të shtetases Suela Beluli rezulton e regjistruar pasuria nr. ***-N**, e llojit “njësi”, pallati **, kati *, me sip. totale 36.7 m², ndodhur në lagjen “5 M”, Elbasan.

27. Nga aktet ka rezultuar se nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 27.12.2007, ndërmjet palës shitëse Z.A.T, S.T, M.T, S.T dhe palës blerëse Suela Beluli është shitur pasuria “njësi”, me sip. 36.7 m², pronë e cila ndodhet në lagjen “5 M”, pallati nr. **, Elbasan, në shumën 1.900.000 lekë, vlerë e cila është likuiduar totalisht *cash* jashtë zyrës noteriale.

28. Ujësjetës Kanalizime Elbasan⁶ informon se në emër të shtetases Suela P. Beluli rezultojnë kontratat nr. *** dhe nr. ***, me vendndodhje në lagjen “5 M”, rruga “M.D”, kategoria biznes me nr. pasurie ***-N **. Evidentohen dy kontrata për të njëjtin objekt. Bashkëlidhur përgjigjes së UKE-së rezulton vërtetimi hipotekor për njësinë me sip. 36.7 m² në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

29. Për dy kontratat e furnizimit në të njëjtën njësi subjekti⁷ ka shpjeguar se: *“Dy kontratat e ujit me nr. *** dhe ***, i përkasin të njëjtës pasuri, asaj me nr. ***-N **, e llojit ‘njësi’, e regjistruar në emrin tim, pasuri e deklaruar nga ana ime. Në këtë njësi ka pasur dhe ka aktualisht dy tualete dhe është e strukturuar në mënyrë që të funksionojë edhe si dy ambiente të ndara. Për këtë arsye, secili tualet ka lidhje më vete të ujit dhe faturohet me matës më vete. Në periudha të ndryshme njëra nga lidhjet është pezulluar dhe riaktivizuar sërish”*.

30. FSHU-ja⁸ informon se referuar sistemit të faturimit në emër të shtetases Suela Beluli rezulton një abonent me kontratë furnizimi të regjistruar në instancën e Elbasanit e kategorisë privat.

31. “Raiffeisen Bank”⁹ ka konfirmuar se shtetasja Suela P. Beluli ka qenë klient i bankës dhe ka pasur kredi në shumën 1.560.000 lekë, marrë në datën 19.8.2005 dhe mbyllur në datën 8.9.2010. Lidhur me këtë kredi, banka nuk disponon dokumente sepse pas plotësimit të afatit 12-vjçar (që nga data e disbursimit të kredisë) dokumentet janë asgjësuar. Referuar kontratës së kredisë, depozituar nga subjekti pranë ILDKPKI-së, ka rezultuar se kredia në shumën 1.560.000 lekë është marrë me qëllim përdorimin e fondeve për mobilim.

Burimi i krijimit

se i shesin blerësit këtë pasuri kundrejt shumës 1.900.000 lekë, vlerë e cila është likuiduar totalisht *cash* jashtë zyrës noteriale; kontratë kredie (personale, mobilim etj.) nënshkruar në datën 18.8.2005 ndërmjet palës kredidhënëse “Raiffeisen Bank” dhe palës kredimarrëse Suela Beluli, bashkëkredimarrës A.B, të një kredie në shumën 1.560.000 lekë, me qëllim përdorimin e fondeve për mobilim. Afati i shlyerjes së kredisë 60 muaj. Barrëdhënësi vendos në favor të bankës një barrë siguroese në mobilieri (dhomë gjumi, soxhorno druri, komplet kolltuqe, kuzhinë gatimi, tavolinë me karrige). Të gjitha mobiliet kushtojnë 1.950.000 lekë. Mobiliet janë blerë sipas faturës së shitjes datë 16.8.2005 nga shoqëria “Sh.Sh” Elbasan.

⁵Shkresat nr. *** prot., datë 6.9.2017 dhe datë 10.10.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

⁶Shkresë nr. *** prot., datë 10.8.2021.

⁷ Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me *email*-in e datës 1.12.2022.

⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 23.7.2022.

⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2012.

32. Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se njësia është blerë:

- me kredi bankare në “Raiffeisen Bank” në shumën 1.560.000 lekë, marrë në datën 18.8.2005;
- pjesa tjetër nga të ardhura të kursyera nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit.

33. Fillimisht, Komisioni nuk konsideroi si burim për blerjen e njësisë shumën e kredisë 1.560.000 lekë, pasi kishin rezultuar rrethanat si vijon:

- Subjekti kishte blerë njësinë në vitin 2007 dhe ka deklaruar si burim kredinë e marrë para 2 vitesh në datën 19.8.2005.
- Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë në “Raiffeisen Bank” u evidentua se kredia është disbursuar në datën 19.8.2005. Në datën 22.8.2005 subjekti ka tërhequr *cash* shumën 1.000.000 lekë dhe në datën 7.9.2005 ka tërhequr *cash* shumën 600.000 lekë.
- Nga të dhënat bankare janë evidentuar gjithashtu depozitime në shumën 1.250.000 lekë në llogarinë e subjektit në “Alpha Bank” në datën 24.11.2005. Kjo depozitë është tërhequr në datën 17.1.2006, para afatit të maturimit. Subjekti ka shpjeguar¹⁰ se shuma prej 1.250.000 lekësh, e depozituar *cash* në datën 24.11.2005, ka pasur si burim kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” në datën 18.8.2005.
- Në objektin e kontratës së kredisë referohet se kjo kredi është marrë për qëllim mobilimi, ndërkohë që subjekti ka deklaruar se e ka përdorur për blerjen e njësisë.
- Në vijim, subjekti me bashkëshortin kanë udhëtuar në shtetin kanadez disa herë në periudhën prill 2005 - gusht 2006.
- Pasi kthehen nga Kanadaja, 2 vjet pas marrjes së kredisë në “Raiffeisen Bank”, subjekti ka blerë njësinë në datën 27.12.2007.

Analiza financiare

34. Analiza financiare për mundësinë e blerjes së njësisë në vitin 2007 u krye për periudhën 2005 – 2007. Kjo për faktin se subjekti¹¹ kishte deklaruar pasuritë dhe likuiditetet në DPV deri në dhjetor të vitit 2004 dhe në këtë deklaram të saj nuk ishin deklaruar kursime *cash*.

35. Në analizën e paraqitur në tabelën vijuese janë përfshirë të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të përlllogaritura sipas vërtetimeve të lëshuara nga institucionet, si dhe kreditimet në llogaritë respektive në banka për periudhën në të cilën janë kaluar me bankë.

36. Janë analizuar gjendjet e likuiditeteve në bankë për subjektin dhe bashkëshortin. Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur për dy persona sipas standardit të ILDKPKI-së. Shpenzimet për udhëtime janë përlllogaritur sipas shpjegimeve të subjektit për shpenzimet në Kanada, si dhe referuar lëvizjeve të gjeneruara nga sistemi TIMS, mbërritur me shkresën e Drejtorisë së Policisë. Për periudhën ku subjekti dhe bashkëshorti kanë qëndruar në

¹⁰Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 21.11.2022.

¹¹Për shkak të detyrës së saj si oficer i policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Kanada në vitin 2006, shpenzimet e jetesës janë zbritur për tre muaj duke qenë se janë përlllogaritur shpenzime qëndrimi jashtë vendit.

37. Në lidhje me njësinë, në përgjigje të pyetësorit¹² subjekti ka deklaruar se ka shpenzuar gjithashtu 500.000 lekë për përshtatjen e ambientit të blerë si butik, direkt pas blerjes. Kjo shumë është përlllogaritur si shpenzim.

38. Referuar dokumentacionit të administruar në dosje ka rezultuar se kredia është disbursuar në datë 19.08.2005, marrë me destinacion mobilimin e shtëpisë në përdorim. Nisur nga fakti se kredia është marrë gati 2 vite përpara se të blihej njësi, në rezultatet paraprake të hetimit, Komisioni në analizën financiare nuk ka përfshirë kredinë, si burim për blerjen e njësisë.

Konstatime të Komisionit për njësinë

39. Nga hetimi administrativ i Komisionit u konstatua se:

i. Mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e njësisë dhe investimet e tjera, pasi nga analiza financiare rezultoi me balancë negative në shumën 2.017.827 lekë.

ii. Mospërputhje deklarimesh lidhur me destinacionin e kredisë, marrë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2005, pasi në kontratën e kredisë referohej që kredia merrej për mobilim banese, ndërsa subjekti ka deklaruar përdorimin e fondeve për blerjen e njësisë në Elbasan në vitin 2007, në shumën 1.900.000 lekë.

40. Barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

41. Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka depozituar prapësime, si dhe akte provuese¹³ ku ka shpjeguar se Komisioni duhet të përfshijë në analizën financiare shumën e marrë kredi nga “Raiffeisen Bank”, për shkaqet vijuese:

i. Për blerjen e njësisë, kontrata e shitblerjes, nënshkruar nga subjekti dhe pala shitëse, ka qenë veprimi i fundit juridik për të finalizuar kalimin e pronësisë së kësaj pasurie. Subjekti ka shpjeguar se për blerjen e njësisë kishte rënë dakord me pronarët e truallit, 2 vjet përpara se të nënshkruhej kontrata e shitblerjes, pra që në vitin 2005. Konkretisht, në datën 30.9.2005 është lidhur një kontratë porosie me palë shtetasit Z.A.T, M.T dhe porositëses Suela Beluli.

Në përmbushje të parashikimeve të kontratës së porosisë, në ditën e nënshkrimit të këtij akti, nga subjekti është paguar shuma 600.000 lekë si këst i parë. Kësti i dytë është paguar në datën 17.1.2006 në shumën 1.200.000 lekë dhe pagesa e fundit në shumën 100.000 lekë

¹²Datë 7.11.2022.

¹³Subjekti ka depozituar aktet: kopje të kontratës së sipërmarrjes, datë 30.9.2005 dhe planimetria, gjithsej 4 fletë; deklarata noteriale nr. ***, datë 21.1.2023, me deklarues M.T, 2 fletë, ku deklarohet se janë kryer pagesat 600.000 lekë dhe 1.200.000 lekë; shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2023, e “Raiffeisen Bank”, 1 fletë; komunikimi me *email* me z. Gj. P, 1 fletë; deklarata datë 23.1.2023, e nënshkruar nga z. Gj.P (xhaxhai) 1 fletë; kopje e pasaportës kanadeze në emër të z. Gj.P, 1 fletë.

është paguar në datën 27.12.2007, datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë.

Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të saj, ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.1.2023, lëshuar nga z. M.T, si ish-pronar i truallit. Referuar këtij akti, z. T deklaron se në datën 17.1.2006 ka marrë dorazi si këst të dytë shumën 1.200.000 lekë, sipas kontratës së porosisë datë 30.9.2005, nga porositësi Suela Beluli.

Subjekti shpjegon se në lidhje me këtë pasuri, në vijimësi, ka mbajtur të njëjtin qëndrim për burimin e krijimit të saj, pasi ka deklaruar se është blerë me shumën 1.560.000 lekë, të përfituar nga kredia në “Raiffeisen Bank”, si dhe të ardhura nga paga e saj dhe e bashkëshortit. Të njëjtin burim krijimi, subjekti e ka deklaruar që në fillim dhe në vazhdimësi në deklaratën *Vetting*, në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në çdo deklaratë apo pyetësor ku është kërkuar informacion për këtë pasuri.

Për të mbështetur shpjegimet e saj dhe në zbatim të kontratës së porosisë, të depozituar si provë, pas kalimit të barrës së provës subjekti ka evidentuar se: *“Duke iu referuar lëvizjeve të llogarisë në emrin tim në ‘Raiffeisen Bank’, rezulton se kredia është disbursuar në datën 19.8.2005. Në datën 22.8.2005 është tërhequr shuma 1.000.000 lekë dhe në datën 7.9.2005 është tërhequr shuma prej 600.000 lekësh.*

Shuma prej 600.000 lekësh është paguar në datën 30.9.2005, si këst i parë për blerjen e njësisë. Pjesën tjetër të shumës së përfituar nga kredia dhe të ardhura nga paga në shumën totale prej 1.250.000 lekësh e kam depozituar në llogarinë time në ‘Alpha Bank’ në datën 24.11.2005, si një depozitë me afat, me qëllim pagimin e këstit të dytë të njësisë, që sipas kontratës së sipërmarrjes ishte rënë dakord të paguhej brenda një periudhe prej 6 muajsh nga data e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes. Kjo depozitë është tërhequr në datën 17.1.2006, para afatit të maturimit, e cila bashkë me interesat arrinte në vlerën 1.270.000 lekë. Nga e gjithë shuma e tërhequr, vlera prej 1.200.000 lekësh i është dhënë z. M.T si pagesë e këstit të dytë për blerjen e njësisë, ndërsa shuma prej 70.000 lekësh është përdorur për shpenzime të tjera”.

ii. Në lidhje me ndryshimin e destinacionit të kredisë, subjekti ka shpjeguar se prej saj dhe bashkëshortit nuk u realizua blerja e mobilieve, sipas qëllimit të kredisë, sepse një pjesë e mobilieve ishin shitur kur u disbursua kredia dhe për këtë shkak duhet të prisnin.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe u ishte paraqitur mundësia për blerjen e njësisë dhe pasi ajo dhe bashkëshorti e vlerësuan situatën, menduan se ishte me më shumë interes investimi në pasuri të paluajtshme si një investim afatgjatë. Subjekti shpjegoi se: *“Në opinionin tim nuk ka peshë ndryshimi i destinacionit të kredisë, pasi vetë ‘Raiffeisen Bank’ ka shpjeguar se në kushtet kur shuma e marrë hua nga banka ishte marrë si një kredi konsumatore dhe në kontratë nuk ishte parashikuar ndonjë detyrim për të njoftuar bankën apo për të kthyer kredinë, kam vijuar me përdorimin e shumës së kredisë sipas destinacionit që kishte interes më të madh në atë moment për familjen time.*

*Mungesa e këtij detyrimi konfirmohet edhe nga përgjigja nr.**prot., datë 17.1.2023, lëshuar nga ‘Raiffeisen Bank’, në të cilën ndër të tjera citohet se: ‘Në kontratën e kredisë*

nuk është përcaktuar detyrimi i kredimarrësit për të njoftuar bankën në lidhje me ndryshimin e qëllimit të kredisë dhe përdorimin e këtyre fondeve për një qëllim tjetër”

iii. Subjekti ka shpjeguar se për shpenzimet e udhëtimit në Kanada në vitet 2005 dhe 2006 nuk janë përdorur shumat e kredisë të “Raiffeisen Bank” pasi këto udhëtime janë përballuar me të ardhura të tjera dhe nuk kanë cenuar apo ndikuar në ndonjë lloj forme në planin për investimin në blerjen e njësisë.

Subjekti shpjegon se: *“Udhëtimi në Kanada në vitin 2005, ku kemi qëndruar vetëm tri javë, është kryer në muajin maj, para lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, si dhe përpara disbursimit¹⁴ të kredisë nga “Raiffeisen Bank”. Në Kanada unë kam qëndruar në shtëpinë e xhaxhait tim Gj.P, duke mos pasur shpenzime të tjera (hotel dhe ushqim) veç shpenzimeve të udhëtimit për të gjithë periudhën e qëndrimit 24.4.2005 - 16.5.2005. Kjo konfirmohet edhe nga deklarata e nënshkruar nga xhaxhai im, të cilën për shkak të largësisë dhe afatit të shkurtër ma ka dërguar nëpërmjet email-it.*

Ndërsa në periudhën e udhëtimit të dytë në Kanada (në periudhën mars - gusht 2006), nga ana ime ishte paguar edhe kësti i dytë për blerjen e njësisë (datë 17.1.2006) duke mbetur pa shlyer vetëm shuma prej 100.000 lekësh. Shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në Kanada për këtë periudhë janë shpjeguar në mënyrë të detajuar në pyetësorët e mëparshëm”.

iv. Përveç sa më sipër, veprimet për porositjen dhe blerjen e njësisë janë kryer në periudhën 2005 – 2007, shumë vite para fillimit të detyrës së subjektit si prokurore. Subjekti ka pretenduar se problematikat në lidhje me këtë periudhë nuk janë të mjaftueshme për të penalizuar subjektin e rivlerësimit.

Shpjegimet dhe provat e sipërcituara konfirmojnë plotësisht se kredia e marrë pranë “Raiffeisen Bank”, në datën 18.8.2005, në shumën 1.560.000 lekë, ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë me nr. ***-N**, e llojit “njësi”, pallati **, kati *, me sipërfaqe totale 36.7 m².

v. Subjekti ka pretenduar se Komisioni në analizën financiare të kryer për blerjen e njësisë për periudhën 2005 – 2007 ka përfshirë si shpenzim shumën 500.000 lekë, përdorur për përshtatje të njësisë, gabimisht në analizën e vitit 2007. Subjekti ka shpjeguar se për kryerjen e këtyre punimeve ka marrë një kredi pranë Fondit B në datën 24.12.2007, dhe ishte objektivisht e pamundur që këto punime të jenë kryer brenda vitit 2007, pasi kredia është disbursuar në ditët e fundit të vitit. Kontrata e shitblerjes është nënshkruar në datën 27.12.2007 dhe, për këto arsye, Komisioni këto shpenzime duhet t’i llogarisë në vitin pasardhës, 2008.

Përfundimisht, nga ana e subjektit u kërkua që në analizën financiare të përfshihet shuma e kredisë prej 1.560.000 lekësh, si burim për blerjen e njësisë për periudhën 2005 – 2007, dhe shpenzimet prej 500.000 lekësh për përshtatjen e njësisë të llogariten për vitin 2008.

¹⁴Kredia është disbursuar në datën 19.8.2005.

Vlerësimi i Komisionit

42. Komisioni, lidhur me pasurinë njësi me sip. 36.7 m², analizoi të gjithë dokumentacionin e administruar, faktet dhe rrethanat e çështjes, si dhe shpjegimet e subjektit si gjatë hetimit dhe në prapësime duke evidentuar si më poshtë.

i. Në lidhje me kredinë e marrë nga subjekti pranë “Raiffeisen Bank”, Komisioni mori në konsideratë rrethanat vijuese:

- Subjekti ka shpjeguar se kontrata e shitblerjes së njësisë ishte veprimi juridik i fundit i nënshkruar me pronarët e njësisë. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka depozituar një kontratë të nënshkruar nga palët: pronari i truallit me cilësinë e sipërmarrësit dhe subjekti Suela Beluli si palë porositëse. Nga përmbajtja e këtij akti, palët kanë parashikuar se në datën e nënshkrimit të kontratës do të paguhej shuma prej 600.000 lekësh dhe brenda 6 muajsh do të paguhej shuma prej 1.200.000 lekësh. Palët fillimisht kanë operuar me një kontratë të thjeshtë, ku kanë përcaktuar çmimin e shitjes dhe mënyrën e likuidimit, dhe jo me një akt noterial. Komisioni arsyeton se referuar dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, për kontratën e sipërmarrjes, neni 850 e vijues, nuk ka parashikuar si kusht për vlefshmërinë e kontratës së sipërmarrjes, hartimin e saj si akt noterial. Për pasojë, Komisioni administron me cilësinë e provës këtë kontratë dhe çmon të marrë në konsideratë për sa konfirmohet në të, duke reflektuar në analizë pagesat e kryera sipas saj.

ii. Në lidhje me kredinë dhe ndryshimin e destinacionit të saj, Komisioni vlerëson se kjo kredi dhe përdorimi i saj është deklaruar prej subjektit në deklaratën e parë të pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2015, si një ndër burimet për blerjen e njësisë. Këtë deklaram subjekti e ka rikonfirmuar në deklaratën e pasurisë *Vetting*, si dhe gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision. Marrë në konsideratë këto deklarime, rezulton se subjekti ka qenë konsekuent në deklaramet e saj, se kjo kredi ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli.

Në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe fakteve të rezultuara përgjatë hetimit administrativ, mbështetur në dokumentacionin e administruar, konstatohet se njësia me sip. 36.7 m² është e vetmja pasuri e blerë nga subjekti, sipas kontratës së blerjes së datës 27.12.2007, që daton vite përpara marrjes së detyrës së saj si prokurore dhe, në këtë situatë, mungojnë të dhëna të sakta për të qartësuar situatën dhe për të kryer një analizë financiare të saktë.

Në këtë kontekst dhe në konsideratë të faktit që kjo pasuri është blerë në një kohë që subjekti nuk kishte detyrim për të deklaruar pasuritë, faktit që Komisioni nuk mund të verifikojë deklaramet e subjektit me faktet e kohës kur kanë ndodhur dhe ndryshimi i destinacionit të kredisë nuk merr peshë dhe nuk konsiderohet si veprim, i cili do të cënonte vlerësimin final të saj, për aq kohë sa këto veprime nuk vijnë në kundërshtim me ligjin, si dhe nuk kanë sjellë pasoja negative për bankën apo palë të treta.

iii. Në lidhje me pretendimet e subjektit se për udhëtimet dhe qëndrimin e saj në Kanada nuk ka përdorur fondet e kredisë, marrë në “Raiffeisen Bank”, por është ndihmuar nga xhaxhai i saj, ajo ka depozituar prova me të cilat provoi që xhaxhai i saj është shtetas

kanadez dhe ka deklaruar se ka qëndruar tek ai, për udhëtimet në Kanada. Për Komisionin është e natyrshme të pranohen pretendimet e subjektit se ka qëndruar fillimisht tek xhaxhai dhe për shkak të rrethanës të afërt familjare dhe të traditës së familjeve shqiptare, duket e besueshme që është ndihmuar prej tij.

Gjithashtu, subjekti gjatë hetimit administrativ depozitoi dokumentacion, me të cilat provoi se është trajtuar me asistencë financiare nga shteti kanadez dhe shuma e kësaj asistence, referuar analizës financiare, ka qenë ndihmë shtesë për të mbuluar nevojat e subjektit dhe bashkëshortit për banim dhe nevojat jetike për ushqim e shpenzime të tjera në këtë shtet.

iv. Në lidhje me pretendimin e subjektit që shuma prej 500.000 lekësh, e marrë kredi pranë Fondit B në datën 24.12.2007, e cila është përdorur për përshtatjen e njësisë me nevojat e saj dhe arsyetimi i subjektit se kjo kredi objektivisht ishte e pamundur që të përdorej brenda vitit 2007, është një shpjegim i drejtë dhe i logjikshëm për Komisionin, pasi sikurse ka shpjeguar edhe subjekti, kryerja e punimeve bëhet e shtrirë në kohë dhe duket e pamundur të jetë kryer në ditët e fundit të vitit 2007. Marrë në konsideratë edhe faktin që finalizimi i blerjes së njësisë është bërë në datën 27.12.2007, kur u nënshkrua kontrata e shitblerjes. Për pasojë, kjo shumë si shpenzim u reflektua në analizë në vitin pasues 2008.

v. Përfundimisht, Komisioni ka pranuar shpjegimet e subjektit, si dhe dokumentacionin mbështetës të depozituar në prapësime, duke konsideruar përdorimin e kredisë si burim për blerjen e dyqanit dhe shpenzimet për përshtatjen e njësisë të kryera në vitin 2008.

43. Analiza financiare e Komisionit pas prapësimeve paraqitet sipas tabelës vijuese.

Përshkrimi	Periudha 2005 – 2007
PASURI	2 235 925
Njësi me sip. 36.7 m ² , blerë më 21.12.2007, në Elbasan	1 900 000
Automjet tip “BMW”, blerë më 9.6.2007	300 000
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	35 925
PASURI NETO	2 235 925
TË ARDHURA	6 387 378
Të ardhura nga paga e subjektit	1 809 495
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	890 051
Të ardhura nga shitja e automjetit në vitin 2006	250 000
Të ardhura nga shteti kanadez (asistenca në vitin 2006)	627 832
Kredi në “Raiffeisen Bank” më 19.8.2005 (1.560.000 lekë)	1 560 000
Kredi Fondi B më 26.1.2005 (750.000 lekë)	750 000
Kredi Fondi B më 24.12.2007 (500.000 lekë)	500 000
SHPENZIME	4 164 057
Shpenzime jetese	910 164
Shpenzime udhëtimi përfshirë shpenzimet në Kanada	1 513 238
Pagesë këstesh kredie në Fondi B (750.000 lekë)	750 000
Pagesë këstesh kredie në “Raiffeisen Bank”	990 655

44. Komisioni argumenton se balanca negative e rezultuar nga analiza financiare për blerjen e njësisë, nuk është në atë masë sa të passjellë aplikimin e një mase disiplinore.

45. Përfundimisht, u konkludua se subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë Njësi, ka shpjeguar bindshëm burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

46. Banesë në përdorim¹⁵ me sip. 124.6 m², kati i dytë në një objekt 3-katësh, në pronësi të babait të bashkëshortit. Subjekti ka deklaruar se në vitin 1999 janë kryer punimet e fundit të ndërtimit, të cilat kanë konsistuar në: shtesë banesë 3-katëshe dhe shtesë 2 kate sipas lejes së ndërtimit, miratuar me vendimin nr. *, datë 22.9.1999, të KRRT Bashkia Elbasan. Punimet kanë përfunduar në vitin 2000 dhe që prej asaj kohe nuk ka ndryshime në shtim apo pakësim të sipërfaqes së këtij objekti. Kjo pasuri është e regjistruar në vitin 2006 në ZVRPP-në Elbasan me nr. pasurie ***, z. k. ***, në pronësi të shtetasit T.B.

Hetimi i Komisionit

47. Në deklarinimin e parë të vitit 2003, kjo pasuri është deklaruar nga subjekti si adresë banimi: lagjja “Ç”, rruga “F.K”, nr. **, Elbasan. Në pyetësorin standard¹⁶ subjekti ka shpjeguar se: *“Në kohën kur kam marrë detyrën e prokurores, në datën 4.6.2015, unë jetoja bashkë me bashkëshortin tim A. B, në shtëpinë e prindërve të bashkëshortit, në të cilën kemi jetuar që prej martesës sonë në vitin 1999 e në vijim pa kundërshpërblim...”*.

48. Në lidhje me origjinën e kësaj pasurie¹⁷, subjekti ka shpjeguar se: *“Pasuria e regjistruar në emër të z. T.B, me nr. ***, ‘ndërtesë’ me sip. 124.6 m² është ndërtuar mbi një truall me sip. 145.5m², në pronësi të z. T.B, me nr. **. Pasuritë që z. T.B zotëron aktualisht janë:*

- pasuria nr. ***, vol. **, f. **, e llojit ‘ndërtesë’, me sip. 124.6 m²;

- pasuria nr. ***, vol. **, f. **, e llojit ‘truall’, me sip. 145.5 m², në pronësi të z. T.B. Të dyja këto pasuri kanë si origjinë pasurinë nr. **, vol. **, f. **, e llojit ‘truall + ndërtesë’”.

49. Nga aktet e administruara në dosjen e hetimit rezulton një vërtetim hipotekor me nr. ***, datë 31.1.2006, sipas të cilit rezulton e regjistruar në pronësi të z. T. B pasuria nr. ***, lloji “ndërtesë 3 kate”, me sip. 124.6 m², z. k. ***, në lagjen “Ç”, Elbasan.

50. Shtetasi T.B (vjehtëri i subjektit të rivlerësimit) është pajisur me leje ndërtimi, sipas vendimit nr. *, datë 22.9.1999, të KRRT-së për objektin “banesë 3 kate”, me sip. 89.4 m² dhe shtesë kati mbi objektin ekzistues 1 kat, me sip. 35.2 m². Afati kohor i kësaj lejeje është

¹⁵Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetim nga dokumentet hipotekore të ZVRPP-së Elbasan, ku sipas regjistrimit hipotekor nr. ***, datë 31.1.2006, figuron e regjistruar në pronësi të z. T.B pasuria nr. ***, lloji “ndërtesë 3 kate”, me sip. 124.6 m², ndodhur në z. k. ***, në lagjen “Ç”, Elbasan. Harta treguese e regjistrimit të pasurisë; leje ndërtimi, ku sipas vendimit nr. *, datë 22.9.1999, të KRRT-së është miratuar leja e ndërtimit për shtetasin T.B për objektin shtesë banesë 3 kate me sip. 89.4 m² dhe shtesë kati mbi objektin ekzistues 1 kat me sip. 35.2 m².

¹⁶Ardhur me shkresën nr. ***, datë 15.2.2021.

¹⁷Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2022.

deri në datën 14.4.2000 (koha e lejes fillon që nga momenti i firmosjes nga kryetari dhe sekretari i KRRT-së, të cilët e kanë firmosur në datën 14.10.1999).

51. ASHK Elbasan¹⁸ ka informuar se pasuritë me nr. *** dhe nr. ***, që nga origjina e tyre, në z. k. ***, Elbasan, rezultojnë të jenë regjistruar në emër të shtetasit T.A.B. Pasuria nr. ** (që është origjina e pasurive që vijnë) është një shtëpi e vjetër ekzistuese e regjistruar në radhorin *, me numër rendor ***, datë 9.7.1993, me origjinë regjistri hipotekor me nr. *, datë 3.10.1932, me sip. 200 kut. Në vitin 1999 (regjistrim me sistem hipoteke) pasuria është regjistruar me sip. 127.5 m² truall, nga kjo ndërtesë me sip. 35.2 m², në bazë të kontratës së dhurimit nr. ***, datë 7.7.1993 dhe kontratës së shitjes nr. ***, datë 15.7.1999.

52. Në vitin 2006, në bazë të nenit 25/b, të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, i shfuqizuar, pasuria me nr. ***, nga një regjistër provizor është futur në sistemin e ri të regjistrimit, në bazë edhe të deklaratave të kufitarëve, hartës së vitit 1988, vendimeve gjyqësore nr. ***, datë 16.9.1963, me objekt shtëpi banimi dhe nr. **, datë 7.1.1977, me objekt pjesëtim pasurie.

53. Në vijim, për efekt të regjistrimit të lejes së ndërtimit nr. *, datë 22.9.1999, të KRRT-së Elbasan, pasuria nr. *** mbyllet dhe krijohen pasuritë me nr. ***, e llojit “truall” me sip. 145.5 m², vol. **, f. ** dhe pasuria nr. ***, e llojit “ndërtesë” me sip. 124.6 m², vol. **, f. ***.

54. ASHK-ja referon se nga verifikimi dhe kontrolli i regjistrave të Drejtorisë Rajonale të ASHK-së Elbasan, në pronësi të shtetasit T.B figurojnë të regjistruara pasuritë nr. *** dhe nr. *** të regjistruara në datën 31.1.2006, pasuri mbi të cilat nuk është kryer asnjë transaksion apo ndryshim juridik.

55. FSHU-ja¹⁹ informon se referuar sistemit të faturimit në emër të shtetasit T.B rezulton një abonent me kontratë furnizimi të regjistruar në instancën e Elbasanit, e kategorisë familjare, me adresë rruga “F.K”, lagjja “Ç”. FSHU-ja²⁰ informon gjithashtu se referuar sistemit të faturimit në emër të shtetasit A.B rezulton një abonent me kontratë furnizimi të regjistruar në instancën e Elbasanit, e kategorisë familjare, me adresë rruga “F.K”, lagjja “Ç”.

56. Ujësjiellës Kanalizime Elbasan²¹ informon se në emër të shtetasit T.B rezulton kontrata me nr. ***, me vendndodhje në lagjen “Ç”, kategoria familjar.

57. Nga hetimi i Komisionit për banesën në përdorim ka rezultuar se:

- Shtetasi T.B është pronar i pasurisë me nr. **, me sip. truall 145.5m² dhe i pajisur me leje ndërtimi ka ndërtuar një godinë 3 kate, me sip. 124.6 m².

¹⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2022, përgjigje e ASHK-së Elbasan, kthyer subjektit të rivlerësimit, depozituar në Komision nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ardhur me shkresën nr. ***, datë 25.10.2022.

¹⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 23.7.2022.

²⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 23.7.2022.

²¹Me shkresën nr. ***, datë 10.8.2021.

- Referuar dokumentacionit të depozituar nga ASHK-ja Elbasan²², aktit të kolaudimit për “banesa 3 kate dhe shtesë kati mbi objektin ekzistues”, ndërtimi i kësaj godine ka përfunduar në datën 4.5.2000, brenda periudhës së afatit të lejes së ndërtimit.

- Sipas vërtetimit hipotekor me nr. ***, datë 31.1.2006, rezulton e regjistruar në pronësi të shtetasit T.B pasuria me nr. ***, lloji “ndërtesë 3 kate”, me sip. 124.6 m², ndodhur në z. k. ***, në lagjen “Ç”, Elbasan.

Burimi i krijimit

58. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pasurinë në përdorim me sip. 124.6 m², në pronësi të vjehrrit, por pa deklaruar burimin e krijimit për këtë pasuri. E pyetur nga Komisioni, subjektit ka deklaruar se nuk ka kontribuar në ndërtimin e kësaj pasurie, pasi në kohën e ndërtimit të banesës 3 kate nuk ka qenë në marrëdhënie pune.

59. Pavarësisht këtij fakti, kjo pasuri u hetua nga Komisioni dhe ka rezultuar se:

QKB-ja²³ ka informuar se shtetasit T.B dhe Z.B nuk figurojnë të regjistruar për ushtrimin e ndonjë aktiviteti, si dhe nuk janë të pajisur me leje/licenca/autorizime.

DPT-ja²⁴ informon se shtetasit T.A.B dhe Z.H.B nuk rezultojnë të regjistruar në institucionin tatimor për aktivitet privat, si dhe gjithashtu në sistem nuk figurojnë si të punësuar në sistemin e DPT-së.

ISSH-ja²⁵ ka informuar se:

- shtetasi T.B ka përfituar pension pleqërie nga muaji shtator 1993 e në vijim me masë mujore 26.040 lekë;
- shtetasi Z.B ka përfituar pension pleqërie nga muaji prill 2008 e në vijim në masën 29.391 lekë.

60. Komisioni ka kërkuar informacion bankar në të gjitha bankat e nivelit të dytë për prindërit e bashkëshortit të subjektit. Nga të dhënat bankare ka rezultuar se për periudhën nga viti 2000 e përpara, nuk janë gjeneruar të dhëna bankare për depozitime apo të ardhura që kalojnë në bankë për këta shtetas.

61. Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie subjekti ka shpjeguar²⁶ se: “*Shpenzimet për ndërtimin e objektit janë përballuar nga prindërit e bashkëshortit, të cilët kanë ndjekur punimet, kanë kryer pagesat, si dhe çdo veprim tjetër që lidhet me këtë ndërtim. Ndërtimi i objektit sipas lejes së ndërtimit ka nisur në muajin tetor 1999 dhe ka përfunduar në muajin prill 2000. As unë dhe as bashkëshorti im nuk kemi kontribuar në ndërtimin e objektit 3 kat*”.

²²Me nr. *** prot., datë 21.10.2022, depozituar nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ardhur me shkresën nr. ***, datë 25.10.2022.

²³Me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2021.

²⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2021.

²⁵Me shkresën nr. ***, datë 21.7.2021.

²⁶Në përgjigje të pyetësorit, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2022.

62. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se: *“Ka lidhur martesë ligjore në datën 12.2.1999, por jetesa në këtë banesë (banesë e cila në atë kohë ishte 1 kat) ka nisur në muajin shtator të vitit 1999. Unë sapo kisha përfunduar studimet e larta dhe nuk isha në marrëdhënie pune. Unë kam nisur punë për herë të parë si oficer e policisë gjyqësore në muajin prill 2000. Në dijeninë time, vendimi për ndërtimin e objektit ishte marrë kohë më parë dhe unë si një pjesëtare e re e kësaj familjeje nuk jam përfshirë në këtë vendimmarrje dhe as më është kërkuar të jepja ndonjë kontribut financiar. Gjatë bashkëjetesës në familjen e prindërve të bashkëshortit nga muaji shtator 1999 deri në muajin nëntor 2000, kohë kur ne filluam të jetojmë në katin e dytë të banesës, kemi pasur ekonomi të ndara dhe unë dhe bashkëshorti kemi jetuar me shpenzimet tona”*.

63. Subjekti ka depozituar²⁷ ortofoto të viteve 2001, 2002, 2007, 2015, 2016 dhe 2021, ku nuk duken ndryshime apo zhvillime në këtë pasuri.

64. Referuar fakteve dhe lejes së ndërtimit rezulton se ndërtimi i shtesës ka përfunduar në prill të vitit 2000, në të njëjtën periudhë kur subjekti ka filluar punën si OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan më 25.4.2000.

65. Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacion provues mbi burimet e ligjshme që kanë shërbyer për ndërtimin e apartamentit në përdorim prej saj. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues, duke shpjeguar²⁸ se prindërit e bashkëshortit, për shkak të moshës e mentalitetit të tyre, kanë qenë shumë konservatorë në dhënien e informacionit për gjendjen e tyre financiare, burimet e krijimit të tyre, shpenzimeve dhe nuk i kanë dhënë informacion subjektit, duke insistuar se pasuria është krijuar totalisht me të ardhurat e tyre, fryt vetëm i investimit të tyre dhe se subjekti me bashkëshortin nuk kanë pasur kontribut financiar në ndërtimin e godinës 3-katëshe.

66. Subjekti ka depozituar²⁹ disa akte:

- shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2022, e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Elbasan, ku referohen të dhëna në lidhje me pensionin e pleqërisë të shtetasit T.B, me datë fillimi 1.9.1993 deri më 30.10.2022, si dhe vjetërsinë në punë që ndodhet në këtë dosje, pensioni që i përket periudhës 1.9.1990 – 31.8.1993;
- shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2022, e DRSSH-së Elbasan, ku referohen të dhëna në lidhje me pensionin e pleqërisë të shtetasës Z.H.B, me datë fillimi 25.4.2008 deri në datën 30.10.2022, si dhe vjetërsinë në punë që ndodhet në këtë dosje, pensioni që i përket periudhës 1.1.1994 - 31.12.1997 - 31.7.2006 - 31.12.2007.

67. Gjatë hetimit të Komisionit për pasurinë në përdorim rezultoi e provuar se:

- Banesa në përdorim është në pronësi të vjehrrit të subjektit, z. T.B.
- Është ndërtuar me të ardhurat e vjehrrit T.B dhe bashkëshortes së tij, përpara se subjekti të fillonte një marrëdhënie pune.

²⁷Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2022.

²⁸Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2022.

²⁹Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2022.

- Leja e ndërtimit të shtëpisë është lëshuar në vitin 1999, në emër të shtetasit T.B, për ndërtimin e godinës 3 kate për një periudhë deri në muajin prill të vitit 2000.
- Të gjitha procedurat për marrjen e lejes së ndërtimit e në vijim për regjistrimin e saj me institucionet shtetërore janë ndjekur dhe kryer në emër të shtetasit T.B.
- Referuar aktit të kolaudimit të ndërtesës rezulton se ndërtimi ka përfunduar në muajin prill të vitit 2000.
- Subjekti ka filluar për herë të parë punë si OPGJ në datën 25.4.2000 dhe gjatë hetimit nuk ka rezultuar ndonjë kontribut financiar i saj në ndërtimin e kësaj pasurie.
- Kjo pasuri është deklaruar si pasuri në përdorim dhe si adresë banimi në të gjitha deklaratimet e saj nga momenti i marrjes së detyrës së prokurores në vitin 2015, si dhe në deklaratën *Vetting*.
- Subjekti dhe bashkëshorti janë përdorues të kësaj pasurie dhe vjehrrit e vjehrra e subjektit, referuar edhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, në këtë marrëdhënie nuk kualifikohen në kategorinë e personave të lidhur apo të tjerë të lidhur si dhurues, huadhënës apo huamarrës, mbështetur ky arsyetim edhe në qëndrime të mbajtura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit për çështje të njëjta, si në rastin e vendimit nr. 10/2022 (JR), datë 14.4.2022, për subjektin e rivlerësimit F. I., etj.

68. Për të gjitha faktet dhe rrethanat e mësipërme, Komisioni nuk legjitimohej që t'i kalonte subjektit të rivlerësimit barrën e provës për gjendjen negative që rezultoi nga analiza e kryer mbi mundësitë e vjehrrit për të blerë këtë pasuri, shumë vite përpara se subjekti të merrte detyrën e prokurores.

Konstatime të Komisionit

69. Për banesën në përdorim, u konstatua se subjekti në deklaratën *Vetting* duhet të deklaronte saktë burimet e krijimit edhe pse kjo pasuri ishte në pronësi të vjehrrit. Subjektit iu kërkuan shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

70. Për pasurinë në përdorim, subjekti, gjatë procesit, por edhe në prapësime, ka shpjeguar se: *"...kam deklaruar marrëdhënien e përdorimit për këtë pasuri në deklaratën Vetting ashtu sikurse kjo marrëdhënie ka qenë prezente gjatë gjithë deklaratave të pasurisë, ku unë kam deklaruar adresën time të banimit. Në këtë kuptim, unë kam lejuar organet e rivlerësimit që të verifikojnë dhe kontrollojnë të gjitha të drejtat e mia mbi këtë pasuri.*

Nga ana tjetër, deklarimi i burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë në përdorim nuk lidhet me mungesën e vullnetit nga ana ime për të deklaruar një gjë të tillë, por për pamundësinë për të deklaruar në mënyrë të saktë dhe me dokumentacion provues. Kjo pamundësi i referohej kryesisht gjendjes sime shëndetësore në atë periudhë. Prej fillimit të muajit nëntor 2016 dhe deri në datën 7.5.2017 kur ka lindur vajza, unë kam qenë me regjim shtrati. Këtë e konfirmon edhe fakti se për këtë periudhë unë jam paguar nga Drejtoria

Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier sipas raporteve shëndetësore (bashkëlidhur dokumente shëndetësore që konfirmojnë gjendjen time shëndetësore).

Gjatë procesit të rivlerësimit, unë kam bërë përpjekjet e mia maksimale për të qenë bashkëpunues dhe për të gjetur dhe vendosur në dispozicion të Komisionit dokumentacionin që kam mundur të siguroj në institucionet që disponojnë informacionin në lidhje me vlerën e investimit dhe të ardhurat e vjehrrit dhe vjehrrës për ndërtimin e kryer prej tyre”.

Vlerësimi i Komisionit

71. Në lidhje me pasurinë në përdorim nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, rezultoi e provuar se është pasuri në pronësi të vjehrrit të subjektit, e krijuar shumë vite përpara marrjes së detyrës së prokurores. Referuar akteve të origjinës së kësaj pasurie, figuronte e regjistruar si shtëpi e vjetër në radhorin *, me numër rendor ***, datë 9.7.1993, me origjinë regjistri hipotekor me nr. *, datë 3.10.1932, me sip. 200 kut.

72. Nga hetimi i Komisionit rezultoi që subjekti nuk kishte kontribut financiar në ndërtimin e kësaj banese, si dhe kjo pasuri kishte përfunduar së ndërtuari në muajin prill 2000, kur subjekti sapo kishte filluar marrëdhënien e parë të punësimit të saj si oficer e policisë gjyqësore, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

73. Subjekti, që në deklarinë e saj të parë në vitin 2004, kur mbante detyrën e oficerit të policisë gjyqësore, si dhe në deklarinë vijuese ka deklaruar saktë pasurinë në përdorim dhe se ishte në pronësi të vjehrrit.

74. Në vlerësim përfundimtar, lidhur me përdorimin e banesës së prindërve të bashkëshortit, për sa kohë nga hetimi i Komisioni nuk u ngritën dyshime për pasuri të fshehur të subjektit, mosdeklarimi i burimit të krijimit të kësaj pasurie mbetet një pasaktësi në deklarinë nga ana e subjektit, pa një ndikim negativ për ta konsideruar si deklarinë të pamjaftueshëm të pasurive në kuptim të ligjit.

75. Automjet³⁰ tip “Volkswagen Golf”, vit prodhimi 2005, blerë në vitin 2015, në shumën 700.000 lekë, 100 % në pronësi të subjektit, me burim kredinë e marrë në “Credins Bank”, sipas kontratës së kredisë nr. *, datë 4.6.2015.**

Hetimi i Komisionit

76. DPSHTRR-ja³¹ ka konfirmuar se shtetasja Suela Beluli ka pasur në pronësi automjetin me targë AA *** MJ. Bashkëlidhur ndodhet kontrata e shitjes nr. ***, datë 4.6.2015, me palë shitëse A.O, i përfaqësuar në kontratë nga shtetasi E.K dhe palë blerëse Suela Beluli,

³⁰Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor me targë AA *** MJ, tip “Volkswagen Golf”, me targë AA *** MJ, vit prodhimi 2005, regjistruar në emër të shtetasës Suela Beluli, lëshuar në datën 31.8.2015; kontratë shitjeje nr. ***, datë 4.6.2015, palë shitëse A.O dhe palë blerëse Suela Beluli, të automjetit tip “Volkswagen Golf”, kundrejt çmimit prej 700.000 lekësh, shumë e cila është shlyer jashtë zyrës noteriale; kontratë kredie nr. ***, datë 4.6.2015, me palë kredidhënëse “Credins Bank”, palë kredimarrëse Suela Beluli, dorëzanës A.B, për kredinë me vlerë 870.000 lekë, me qëllim kredi konsumatore, blerje automjeti, afat shlyerje 4 vjet. Plani i amortizimit të kredisë.

³¹Me shkresën nr. ***, datë 26.7.2021.

për automjetit tip “Volkswagen Golf”, kundrejt çmimit 700.000 lekë, shumë e cila është shlyer jashtë zyrës noteriale.

77. Nga hetimi rezultoi se shtetasit A.O e ka blerë këtë automjet nga një shtetas italian, në datën 28.4.2015, në shumën 1.000 euro. Rezulton se ky automjet është shitur nga subjekti në datën 19.5.2020, në shumën 450.000 lekë. Referuar kontratës së kredisë të datës 4.6.2015, me “Credins Bank” rezulton se qëllimi i marrjes së kredisë është për blerje automjeti.

78. Sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS ka rezultuar se pronari i automjetit, z. A. O, ka dalë jashtë Shqipërisë në datën 3.6.2015, ora 21:41 dhe ka hyrë në datën 12.6.2015. Nga faqja e QKB-së, ky shtetas rezulton i regjistruar si person fizik në emër të shtetasit A.O, me objekt veprimtarie “transport automjete brenda dhe jashtë vendit për vete dhe për të tretë me karrotrec” me datë regjistrimi 9.1.2017.

79. Shtetasi E.K, në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së automjetit tip “Volkswagen Golf”, 4.6.2015, rezulton të ketë qenë në Shqipëri.

Analiza financiare

80. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së pagës së subjektit në “Credins Bank” ka rezultuar se në datën 4.6.2015 është disbursuar kredia në shumën 865.650 lekë. Në të njëjtën ditë subjekti ka tërhequr *cash* shumën 922.000 lekë. Duket se subjekti ka disponuar të ardhura për blerjen e këtij automjeti.

81. Konstatime të Komisionit për automjetin

- Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë automjet në përputhje me ligjin.
- Subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit në vitin 2015.

82. **Të ardhura nga qiradhënia**, për periudhën 2015 – 2016, në shumën 165.000 lekë.

83. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar dhe deklarimeve të subjektit³² ka rezultuar se subjekti ka përfituar të ardhura nga dhënia me qira e njësisë, për vitet 2012, 2013, 2015 dhe 2016. E pyetur nga komisioni subjekti ka shpjeguar³³ se për kontratat e qirasë të lidhura për periudhën 2012 – 2015, nuk ka pasur dijeni që nuk ishte paguar tatimi mbi qiratë nga qiramarrësit. Për këtë arsye, kur ka marrë dijeni mbi këtë fakt, ka vijuar të paguajë detyrimet sipas ligjit, të konfirmuara me njoftimin e lëshuar në datën 23.1.2017 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan. Deklarata *Vetting* është dorëzuar nga subjekti në datën 24.1.2017.

84. Për kontratat e qirasë nga momenti i emërimit në detyrë në vitin 2015, pagesat e tatimit në burim kanë rezultuar se janë paguar nga qiramarrësi çdo muaj, sipas dokumentacionit të depozituar. Për të ardhurat nga qiraja, bazuar në legjislacionin tatimor³⁴, detyrimin për të paguar/mbajtur tatimin e ka subjekti tregtar i pajisur me NIPT.

³²Ardhur me shkresën nr. ***, datë 25.10.2022.

³³Pyetësor ardhur me shkresën nr. ***, datë 25.10.2022.

³⁴Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Konstatime të Komisionit për të ardhurat nga qiradhënia

85. Për të ardhurat nga qiradhënia rezultuan të provuara pagesat e tatimit në burim për vitet 2012 – 2016 dhe, për pasojë, janë reflektuar në analizën financiare.

DETYRIME FINANCIARE

86. Kredi³⁵ në vitin 2008, në shumën 25.000 euro, me afat 10-vjeçar, me këst mujor aktual 254 euro, me bashkëhuamarrës bashkëshortin A.B

87. Subjekti ka shpjeguar se kredia është marrë me qëllim blerjeje apartamenti, por kontrata e porosisë është shfuqizuar sipas deklaratës datë 17.6.2008 dhe shuma e marrë sipas kësaj kredie është përdorur për rikonstruksion dhe mobilim të banesës ku jeton aktualisht me bashkëshortin. Kjo banesë ndodhet në katin e dytë të një objekti shtëpi banimi 3 kat, në pronësi të babait të bashkëshortit T.B (përshkrimi i kësaj pasurie është bërë në rubrikën e pasurive të paluajtshme në përdorim të kësaj deklarate). Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer 4.456,47 euro.

Hetimi i Komisionit

88. “Alpha Bank”³⁶ ka konfirmuar kredi në emër të shtetasës Suela Beluli. Nga aktet e dosjes rezulton një kontratë për kufi kredie shumëqëllimore me nr. ***, datë 16.6.2008, me palë kredidhënëse “Alpha Bank” dhe palë kredimarrëse A.B dhe Suela Beluli, nëpërmjet së cilës banka i çel kredimarrësit kufirin e kredisë në shumën 26.000 euro.

89. Në vijim, palët kanë nënshkruar një kontratë huaje nr. ***, datë 16.6.2008, me palë kredidhënëse “Alpha Bank” dhe palë kredimarrëse A dhe Suela Beluli. Në bazë të kontratës nr. ***, datë 16.6.2008, banka i hapi (celi) kredimarrësve një kufi kredie në shumën 26.000 euro. Nga ky kufi është përdorur shuma prej 25.000 euro, për blerje apartamenti. Kredimarrësi ka paraqitur në bankë kontratën e porosisë për blerje apartamenti me kosto të përgjithshme 70.000 euro. Kontributi për financimin e projektit është 45.000 euro, pjesa tjetër 25.000 euro kërkohet të financohet nga banka, me afat shlyerje 10 vjet.

³⁵Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë për kufi kredie shumëqëllimore nr. ***, datë 16.6.2008, me palë kredidhënëse “Alpha Bank” dhe palë kredimarrëse A.B dhe Suela Beluli, nëpërmjet së cilës banka i çel kredimarrësit kufirin e kredisë në shumën 26.000 euro; kontratë huaje nr. ***, datë 16.6.2008, me palë kredidhënëse “Alpha Bank” dhe palë kredimarrëse A.B dhe Suela Beluli. Në bazë të kontratës nr. ***, datë 16.6.2008, banka i hapi (celi) kredimarrësve një kufi kredie në shumën 26.000 euro. Nga ky kufi është përdorur shuma prej 25.000 euro për blerje apartamenti, nëpërmjet kontratës shtesë nr. ***, datë 9.6.2008. Kredimarrësi ka paraqitur në bankë projektin për blerje apartamenti me kosto të përgjithshme 70.000 euro. Kontributi për financimin e projektit është 45.000 euro, pjesa tjetër 25.000 euro kërkohet të financohet nga banka, me afat shlyerje 10 vjet; deklaratë datë 19.1.2017 nga “Alpha Bank” për shtetasit Suela Beluli dhe A.B, të cilëve i është miratuar kredi me limit 25.000 euro. Teprica e kredisë më 19.1.2017 është 4.456,47 euro; nxjerrje llogarie për kredinë në emër të shtetasve Suela Beluli dhe A.B për periudhën 1.1.2016 - 19.1.2017, me gjendje 4.456,47 euro; kontratë porosisë datë 12.5.2008, me palë sipërmarrëse V.K dhe palë porositëse Suela Beluli të një apartamenti me sip. totale 158.4 m² (përfshirë ambientet e përbashkëta), kundrejt shumës totale prej 70.000 euro. Pagesa si këst i parë në vlerën 20.000 euro do të paguhet me lidhjen e kontratës, pagesa tjetër do të bëhet nëpërmjet “Alpha Bank” nëpërmjet kredisë bankare. Vërtetim nënshkrimi të kontratës së porosisë nr. *** rep., datë 12.5.2008, nga noter M. L; deklaratë e shtetasve V.K dhe Suela Beluli, datë 17.6.2008, të cilët deklarojnë se kanë nënshkruar kontratën e porosisë datë 12.5.2008 dhe të legalizuar para noterit me nr. *** rep., datë 12.5.2008, me objekt prenotimin e një apartamenti me sip. 151.9 m² në pallatin që po ndërtohet nga investitori V.K. Me vullnetin e tyre të lirë palët e shfuqizojnë për mungesë financiare dhe deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim ligjor dhe material në natyrë dhe në të holla me njëri-tjetrin.

³⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2022.

90. Në dosje rezulton gjithashtu një kontratë porosie datë 12.5.2008, me palë sipërmarrëse V.K dhe palë porositëse Suela Beluli të një apartamenti me sip. totale 158.4 m² (përfshirë ambientet e përbashkëta), kundrejt shumës totale prej 70.000 euro. PAGESA, si kështu i parë në vlerën 20.000 euro, do të paguhet me lidhjen e kësaj kontrate porosie, pagesa tjetër do të bëhet nëpërmjet “Alpha Bank” nëpërmjet kredisë bankare. Vërtetim nënshkrimi të kontratës së porosisë nr. ***rep., datë 12.5.2008, nga noter M.L.

91. Në vijim, është hartuar një deklaratë ndërmjet palëve V.K dhe Suela Beluli, datë 17.6.2008, të cilët deklarojnë se kanë nënshkruar kontratën e porosisë datë 12.5.2008 dhe të legalizuar para noterit me nr. *** rep., datë 12.5.2008, me objekt prenotimin e një apartamenti me sip. 151.9 m², në pallatin që po ndërtohet nga investitori V.K. Me vullnetin e tyre të lirë palët e shfuqizojnë për mungesë financiare dhe deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim ligjor dhe material në natyrë dhe në të holla me njëri-tjetrin.

92. Subjekti³⁷ ka shpjeguar se: *“Kontrata e porosisë datë 12.5.2008, u nënshkrua për efekt të kryerjes së procedurave për përfitimin e kredisë dhe nuk ishte kryer asnjë pagesë. Pasi u vunë në dijeni të këtij fakti, prindërit e bashkëshortit janë shqetësuar dhe janë ndjerë të braktisur dhe të pavlerësuar për sakrificën që kishin bërë për t’i siguruar dy djemve të tyre një banesë për të jetuar dhe gjatë bisedave në familje kanë dhënë premtimin se banesa ku ne jetonim do të ishte pjesa që bashkëshorti do të përfitonte nga babai i tij. Ndodhur përballë kësaj situate, ne u tërhoqëm nga vendimi për blerjen e një apartamenti dhe vendosëm të qëndrojmë të jetojmë në banesën ku ishim duke jetuar. Gjithashtu, vendosëm, që të vijonim me procedurat për marrjen e kredisë me qëllim për ta përdorur këtë kredi për të kryer rregullime dhe mobilim të banesës, e cila ishte në gjendje tepër modeste si për sa i përket cilësisë së mureve, dyshemesë, tualetit etj. Pjesë e rregullimeve kanë qenë patinim dhe lyerje, shtrim i dyshemesë, rregullim i tualeteve, vendosja e kuzhinës së gatimit, ndërrimi i dyerve dhe dritareve, si dhe blerja e pajisjeve të ndryshme në vitin 2008”.*

- Në përmbajtje të aktit kontratë porosie, datë 12.5.2008, të nënshkruar nga palët, subjekti Suela Beluli dhe shtetasi V.K, shkruhet se është paguar shuma 20.000 euro në datën e nënshkrimit të saj. Komisioni, ka analizuar mundësinë e subjektit për të kryer këtë pagesë.

Konstatime të Komisionit në lidhje me kredinë

93. Nga hetimi i kryer në lidhje me kredinë u konstatua se,

- Analiza financiare e Komisionit mbi mundësitë e subjektit për kryerjen e një pagese 20.000 euro, referuar kontratës së porosisë, ka rezultuar me një balancë negative në shumën 2.703.056 lekë.
- Subjekti ka ndryshuar destinacionin e kredisë, pasi kredia është marrë për blerje apartamenti dhe deklarohet të jetë përdorur për rikonstruksion të banesës në përdorim.
- Nga analizimi i dokumentacionit për marrjen e kredisë, duket se janë kryer veprime fiktive, pasi është nënshkruar një kontratë porosie për blerjen e një apartamenti në

³⁷Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2022.

Elbasan në datën 12.5.2008 dhe një ditë pas miratimit të kredisë në “Alpha Bank”, në shumën 25.000 euro, kjo kontratë porosie është anuluar në datën 17.6.2008.

94. Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

95. Në lidhje me konstatimet e Komisionit subjekti ka shpjeguar se:

i. Komisioni nuk duhet të ngarkojë me balancë negative pagesën e kështit 20.000 euro sipas kontratës së sipërmarrjes, pasi:

Në datën 16.6.2008 kemi nënshkruar kontratën për kufi kredie shumëqëllimore me nr. ***, me palë kredidhënëse “Alpha Bank”, nëpërmjet së cilës banka ka çelur kufirin e kredisë në shumën 26.000 euro. Kredia është marrë me qëllim blerje apartamenti.

Për marrjen e kësaj kredie është nënshkruar edhe kontrata e porosisë datë 12.5.2008, me sipërmarrësin V.K. Pavarësisht se në kontratën e porosisë është pasqyruar fakti se paguhet kësti prej 20.000 euro, në fakt kjo pagesë nuk është kryer. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 20.1.2023, me deklarues shtetasin V.K, i cili deklaroi se nuk është bërë pagesa prej 20.000 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes dhe as në vijim.

Në vijim, për shkak të rrethanave familjare të sqaruara edhe gjatë përgjigjeve të dhëna në një nga pyetësorët gjatë këtij procesi, ata u tërhoqën nga vendimi për blerjen e apartamentit dhe vendosën të qëndronin për të banuar në banesën ku ishin duke jetuar. Ndodhur përballë nevojës për të jetuar në një banesë me kushte normale, vendosën të vijonin procedurat për marrjen e kredisë me qëllim për ta përdorur këtë kredi për të kryer rregullime dhe mobilim të banesës. Vlera e rikonstruksionit dhe mobilimit ka shkuar 20.000 euro, ndërsa pjesa tjetër e kredisë në shumën 5.000 euro është përdorur për shlyerjen e saj.

Subjekti ka shpjeguar se kontrata e porosisë është shfuqizuar sipas deklaratës datë 17.6.2008, ku është pasqyruar fakti se kontrata e porosisë revokohet për mungesë financiare dhe palët nuk kanë asnjë detyrim ndaj njëri-tjetrit.

Pagesa prej 20.000 euro nuk është kryer, pasi, nëse realisht do të disponoja këtë shumë parash në momentin e revokimit të kontratës së porosisë, nuk do të kisha vijuar me marrjen e kredisë dhe shpenzimet për rikonstruksion dhe mobilim do t'i kisha përballuar me paratë që do disponoja.

ii. Subjekti ka shpjeguar se, nuk është kryer ndonjë veprim fiktiv për marrjen e kredisë, pasi kredia është kërkuar për të përmbushur nevojën e familjes së saj për të krijuar kushte normale jetese dhe banimi. Tërheqja nga ky investim më tej ka ardhur për shkak të rrethanave familjare dhe fondi është investuar pikërisht për të plotësuar këto nevoja.

Marrëdhënia e krijuar midis kredidhënësit dhe kredimarrësit në këtë rast është një marrëdhënie juridiko-civile e lidhur mes palëve me pëlqimin dhe vullnetin e tyre. Banka, si një institucion financiar privat, pasi ka vlerësuar se huamarrësit kanë plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara si për kolateralin dhe për mundësinë e shlyerjes së kësteve të kredisë,

ka vendosur dhënien e kredisë dhe mandej disbursimin e kësaj kredie. Subjekti dhe bashkëshorti, në cilësinë e kredimarrësve, kanë shlyer rregullisht këstet e kredisë deri në mbylljen e saj dhe nga ana e palës kredidhënëse nuk janë konstatuar shkelje të kontratës së kredisë.

Në të gjitha deklaratat e pasurisë ka pasqyruar ndryshimin e destinacionit të kredisë dhe nuk e ka fshehur në asnjë rast këtë fakt.

Gjithashtu, veprimet për marrjen e kredisë dhe përdorimi i saj janë kryer shumë vite para se subjekti të ushtronte funksionin si prokurore.

Për sa më sipër, nga ana e Komisionit nuk duhet të pasqyrohet në analizën financiare shuma prej 20.000 euro, si shpenzim i kryer për pagimin e këstit të parë sipas kontratës së porosisë datë 12.5.2008, pasi një gjë e tillë nuk ka ndodhur në fakt. Ashtu sikurse vlera e shpenzimit për rregullimin e banesës duhet të llogaritet në shumën 20.000 euro, dhe jo 25.000 euro.

Vlerësimi i Komisionit

96. Në lidhje me Kredinë e marrë në vitin 2008 nga subjekti, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi i Komisionit, si dhe shpjegimeve të subjektit në prapësime rezulton se: (a) në vlerësim të tërësisë së veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe fakteve të rezultuara nga hetimi i Komisionit, krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh, të cilat duket se kanë pasur për qëllim të vetëm marrjen e kredisë bankare në shumën 26.000 euro; (b) në lidhje me destinacionin e kësaj kredie, nuk rezultoi që kredia të ketë shërbyer për të krijuar pasuri, fakt i konfirmuar gjatë hetimit, pasi nuk rezultoi që subjekti të ketë finalizuar blerjen e apartamentit; (c) sikurse rezulton, aktet janë hartuar brenda vitit kalendarik, palët janë kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme, si dhe duket se veprimet e kryera nuk kanë sjellë apo krijuar efekte financiare mes tyre, e aq më pak pasoja negative për bankën (me ndryshimin e destinacionit të saj) apo palëve të treta. Në këto kushte, u konkludua se pagesa prej 20.000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës nuk mund të jetë kryer, pasi siç rezultoi dhe nga analiza, subjekti ka rezultuar me një pamundësi financiare, nga ku duket qartë se kredia është marrë për të mbuluar shpenzimet për rregullime në banesë.

97. Për sa më sipër, trupi gjykues nuk gjeti asnjë rrethanë dyshuese që mund të lidhej me ndonjë pasuri të krijuar nga subjekti i rivlerësimit apo rrethana të tjera që mund të lidhen me periudhën e rivlerësimit objekt shqyrtimi nga Komisioni, si dhe nuk e gjen subjektin e rivlerësimit në asnjë nga rrethanat e nenit 33 pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

98. Marrëveshje huaje³⁸ në llogari rrjedhëse (*overdraft*) në “Credins Bank”, e rinovueshme në janar të çdo viti në shumën 50.000 lekë. Shuma e detyrimit financiar që ka

³⁸Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin datë 19.1.2017 nga “Credins Bank” për znj. Suela Beluli, e cila ka përfituar *overdraft* të lidhur me pagën me limit në shumën 50.000 lekë. Ky *overdraft* është përdorur deri në datën 19.1.2017 në shumën 20.827,82 lekë.

mbetur e pashlyer: 20.827 lekë. “Credins Bank”³⁹ ka konfirmuar llogarinë e pagës në emër të shtetases Suela Beluli.

✓ Përputhen deklaratimet e subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje.

99. Kredi⁴⁰ në shumën 100.000 lekë, marrë në datën 30.10.2014 pranë BKT-së për një afat 36-mujor, me kësht mujor 3.192,31 lekë, me kredimarrës bashkëshortin e subjektit A B. Banka Kombëtare Tregtare⁴¹ ka konfirmuar kredinë, aktualisht të shlyer.

✓ Nga hetimi i kryer, përputhen deklaratimet e subjektit me dokumentacionin e ardhur.

Të dhëna konfidenciale të deklaruara nga subjekti

100. Hua⁴² në shumën 3.000 euro, marrë shtetasit L.F (daja e subjektit)

101. E pyetur nga Komisioni gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Këtë shumë parash e kam marrë hua për qëllim të një trajtimi mjekësor pranë Spitalit. A. Tiranë në muajin shtator - tetor 2016”*. Në mbështetje të këtyre shpjegimeve subjekti ka depozituar⁴³ një dokument të lëshuar nga Spitali A, *“Përmbledhje të pagesave për periudhën shtator - tetor 2016”*, ku provohen pagesat e kryera sipas deklaratimeve të subjektit.

102. Për këtë hua është mbajtur një deklaratë e nënshkruar nga të dyja palët. Për shkak të llojit të trajtimit mjekësor ky informacion jepet në këtë rubrikë dhe deklarata nuk është përpiluar para një noteri (deklaratë datë 17.9.2016).

Hetimi i Komisionit

103. Pasi është pyetur nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar⁴⁴ se: *“Z. L.F, i cili më ka dhënë huan në shumën 3.000 euro sipas deklaratës datë 17.9.2016, jeton dhe punon me familjen e tij që prej vitit 1991 në Greqi. Shuma 3.000 euro ka si burim të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes së tij, znj. F.F, nga pagat. Për të vërtetuar të ardhurat dhe faktin se në momentin e dhënies së huas në muajin shtator të vitit 2016 z. L.F e posedonte këtë shumë, iu vendos në dispozicion lëvizjet e kryera në llogarinë pranë Eurobank në Greqi në emër të z. L.F dhe bashkëshortes së tij, znj. F.F. Në këtë llogari janë derdhur të gjitha pagat për z. L.F dhe znj. F.F, të cilët në atë kohë kanë pasur të njëjtin punëdhënës E.I”*.

104. Komisioni hetoi në lidhje me mundësitë financiare të huadhënësit për shumën 3.000 euro. Nëse i referohemi vetëm muajit gusht 2016 (një muaj para se të jepej huaja), rezultoi se në datën 1.8.2016 në llogari ka pasur një gjendje prej 5.563,72 euro dhe pas kryerjes së

³⁹Shkresë nr. *** prot., datë 18.8.2021.

⁴⁰Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë kredie, datë 30.10.2014, me palë kredidhënëse Banka Kombëtare Tregtare dhe palë kredimarrëse A.B, të kredisë me vlerë 100.000 lekë, me qëllim rregullim shtëpie, me afat shlyerjeje 36 muaj. Plani i amortizimit të kredisë; vërtetim nr. ** prot., datë 19.1.2017, nga Banka Kombëtare Tregtare për z. A.B, i cili ka një kredi pranë kësaj banke. Shuma e mbetur pa shlyer është në shumën 31.080,69 lekë.

⁴¹Shkresë nr. *** prot., datë 30.8.2021.

⁴²Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: deklaratë datë 17.9.2016, e shtetasit L.F, i cili deklaron se po në këtë datë i jep hua mbesës së tij Suela Beluli shumën 3.000 euro, të cilën ajo do e përdorë për një trajtim mjekësor. Këtë shumë ky shtetas e disponon nga të ardhurat nga puna e tij dhe e familjes së tij në Greqi, ku jeton e punon prej vitit 1991. Huaja jepet pa interes dhe kthimi do të bëhet pa afat të caktuar, sipas mundësive financiare të saj. Bashkëlidhur ndodhet karta e identitetit të shtetasit L.F.

⁴³Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2022.

⁴⁴Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2022.

pagesave për shpenzime të ndryshme për jetesën në datën 31.8.2016 gjendja në llogari ka qenë 551,25 euro. Në këtë llogari në muajin gusht janë kryer tërheqje *cash* në ATM në një shumë totale prej 3.780 euro e konkretisht në datat: 2.8.2016 (420 euro); 8.8.2016 (840 euro); 9.8.2016 (840 euro); 22.8.2016 (840 euro); dhe 26.8.2016 (840 euro).

105. Të ardhurat e shtetasve L.F dhe F.F për vitin 2016, sipas deklaratës vjetore të të ardhurave për vitin 2016, janë në total në shumën 28.500 euro. Nga të dhënat e llogarisë bankare rezulton se huadhënësi ka disponuar gjendje të mjaftueshme për të dhënë hua, si dhe rezultojnë tërheqjet e kryera në gusht të vitit 2016.

106. Nga analiza financiare mbi mundësitë e huadhënësit, duke përllogaritur shpenzimet e jetesës sipas shpenzimeve minimale të Eurostat Greqi (për dy persona në vitin 2016 janë 9.000 euro), ka rezultuar se huadhënësi ka pasur të ardhura të ligjshme për të dhënë huan në shumën 3.000 euro.

107. Bazuar në analizën e kryer mbi të ardhurat e ligjshme të huadhënësit për vitin 2016, subjekti ka përmbushur kriteret e parashikuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 për të provuar burimet e ligjshme të huadhënësit për huan në shumën 3.000 euro.

Konstatime të Komisionit

108. Nga hetimi i Komisionit dhe verifikimi i të dhënave nga sistemi TIMS ka rezultuar se shtetasi L.F ka hyrë në Shqipëri në datën 30.4.2016 dhe ka dalë në datën 7.5.2016, për vitin 2006 nuk rezultuan udhëtime të tjera të këtij shtetasi. Për pasojë ngrihen dyshime se daja e subjektit ka rezultuar në Greqi në datën e nënshkrimit të deklaratës për marrjen e huas.

109. Subjektit iu kalua barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar marrjen e huas nga daja e saj, pasi në datën e nënshkrimit të deklaratës, 17.9.2016, për marrjen e huas, bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, ky shtetas ka rezultuar në Greqi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

110. Subjekti në prapësime ka shpjeguar se nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se shtetasi L.F ka hyrë në Shqipëri në datën 10.9.2016 dhe ka dalë në datën 18.9.2016 me dokumentin grek, kartë identiteti nr. AM***, lëshuar në datën 26.6.2015. Subjekti shpjegoi se daja i saj, shtetasi L.F ka edhe nënshtetësi greke, ndaj gjatë hyrje-daljeve nga territori shqiptar përdor edhe letërnjoftim grek.

111. Pas kalimit të barrës së provës, në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka depozituar akte⁴⁵ provuese.

Vlerësimi i Komisionit

112. Mbështetur në dokumentacionin e depozituar në prapësime, sipas të dhënave të administruara, subjekti provoi se në ditën e nënshkrimit të deklaratës daja i saj, shtetasi L.

⁴⁵Për huan e marrë nga shtetasi L.F ka depozituar aktet: (1) shkresë nr. *** prot., datë 19.1.2023, e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan në lidhje me hyrje-daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë, z. F për periudhën 26.6.2015 – 19.1.2023; (2) kopje e kartës së identitetit grek me nr. AM***, në emër të z. L.F.

F ka rezultuar të ishte brenda territorit të vendit, pasi ka përdorur dokument identifikimi të marrë në shtetin grek.

Analiza financiare për periudhën në detyrën e prokurores

113. Subjekti i rivlerësimit është emëruar në detyrën e prokurores në datën 4.6.2015. Për këtë arsye, Komisioni kreu një analizë financiare të përgjithshme të kësaj periudhë dyvjeçare.

Analiza financiare në detyrën e prokurores, për vitet 2015 - 2016

PASURITË	2015	2016
PASURI	642 060	134 713
Automjet tip "Golf", blerë në datën 4.6.2015	700 000	
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	<i>(57 940)</i>	<i>134 713</i>
Likuiditete gjendje	(130 463)	4 250
DETYRIME	870 000	405 810
Kredi në "Credins Bank", datë 4.6.2015	870 000	
Hua marrë z. L.F 3.000 euro		405 810
PASURI NETO	(227 940)	(271 097)
TË ARDHURA	1 712 345	2 261 310
Të ardhura nga paga e subjektit	983 069	1 185 294
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	576 776	586 016
Të ardhura nga qiraja	152 500	90 000
Të ardhura nga shitja e automjetit tip "BMW"		400 000
SHPENZIME	1 903 592	2 339 195
Shpenzime jetese	448 552	391 820
Shpenzime udhëtimi TIMS	519 629	451 569
Shpenzime mjekësore Spitali A		750 000
Pagesë këstesh kredie në "Credins Bank" (900.000 lekë)	297 324	
Pagesë këstesh kredie në "Credins Bank" (870.000 lekë)	133 650	289 666
Pagesë këstesh kredie në BKT (180.000 lekë)	29 769	
Pagesë këstesh kredie në BKT (100.000 lekë)	49 106	39 102
Pagesë këstesh kredie në "Alpha Bank"	425 561	417 037
Rezultati	36 693	193 212

114. Analiza financiare e subjektit për këto dy vite, ka rezultuar me burime të mjaftueshme financiare për të mbuluar shpenzimet.

Gjetje të tjera

115. Në lidhje me adresat e banimit, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: "Prej datës 1.3.2018 deri në datën 13.4.2020 ka jetuar me qira në një apartament me adresë: Njësia Administrative Nr. *, rruga 'R. D', godina nr. *, hyrja nr. *, ap. nr. *, Tiranë. Kjo pasuri është e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 29.9.2003, z. k. ***, Tiranë, në bashkëpronësi të shtetasve T.K dhe K. K (emri i dytë i E.K). Për marrjen me qira të kësaj

banese janë lidhur kontratat e qirasë midis bashkëshortit A.B dhe shtetasit T.K, si më poshtë:

- *kontrata e qirasë datë 1.3.2018, me afat deri në datën 30.9.2019, me qira mujore në vlerën 20.000 lekë;*
- *kontrata e qirasë nr. ***, datë 9.10.2019, me afat 3-vjeçar, me qira mujore në vlerën 20.000 lekë. Kjo kontratë është revokuar me deklaratën noteriale nr.***,datë 13.4.2020.*

Pagesa e qirasë për të gjithë periudhën nga data 1.3.2018 deri në datën 13.4.2020 është kryer cash nga bashkëshorti A.B tek qiradhënësi T.K, në shumën 20.000 lekë/muaj”.

116. Referuar kontratave të qirasë, nga pala qiradhënëse rezulton se janë nënshkruar vetëm nga shtetasi T.K dhe jo nga të dy bashkëpronarët e pasurisë, sipas certifikatës së pronësisë. Apartamenti citohet të ketë një sipërfaqe prej 131 m², e përbërë 2 dhoma gjumi, kuzhinë dite, 2 kuzhina gatimi, 2 tualete dhe 2 korridore.

117. Nga kontratat rezulton se familja e subjektit ka marrë me qira 1 dhomë, 1 kuzhinë, 1 kuzhinë gatimi, 1 korridor dhe 1 tualet, pjesën tjetër e përdor vetë pronari për të mbajtur pajisjet e tij.

118. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se z. T.K (qiradhënësi i apartamentit) ka lindur dhe është banues në Elbasan. Të dyja kontratat e qirasë, revokimi i kontratës së qirasë dhe deklarata noteriale janë hartuar para noterit në qytetin e Elbasanit. Në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të datës 2.2.2021, me deklarues T.K, i cili deklaroi se shtetasi A.B nga data 1.3.2018 deri në datën 13.4.2020 ka paguar çdo muaj shumën prej 20.000 lekësh *cash*, për qiranë e apartamentit në Tiranë, tek shtetasi T.K.

Vlerësimi përfundimtar i kriterit të pasurisë

119. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Suela Beluli ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka kryer deklarime të sakta në deklaratën *Vetting* dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore nuk rezultuan të kenë qenë të qëllimshme apo të kenë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklarime të rreme. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në ndonjë rast, në situatë konflikti interesi.

B. KONTROLLI I FIGURËS

120. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti ka kontakte të pa përshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

121. DSIK-ja ka dërguar raportin në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016⁴⁶ mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Suela P. Beluli, në detyrën e prokurorit.

Hetimi i Komisionit për kontrollin e figurës

122. Komisioni ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga DSIK-ja në vitin 2017, për të cilën ka marrë përgjigje se nuk disponohet informacion shtesë në lidhje me kontrollin e figurës.

123. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Fakte dhe rrethana të dala gjatë hetimit për kriterin e figurës

124. Referuar kontratës për blerjen e automjetit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në datën 4.6.2015 ka blerë automjetin tip “Volkswagen” në shumën 700.000 lekë, me pronar shtetasin A.O, i përfaqësuar nëpërmjet një prokure të posaçme në ditën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes nga shtetasi E.K.

125. Gjithashtu, referuar akteve të administruara, rezulton se subjekti ka marrë me qira një apartament në Tiranë nga data 1.3.2018 deri në datën 13.4.2020, trajtuar në pikën 34 të këtij vendimi, me qiradhënë shtetasin T.K, babai i z. E.K. Sipas certifikatës së pronësisë së këtij apartamenti, bashkëpronarë rezultojnë shtetasit T.K dhe K.K (babë e bir). Sipas të dhënave E.K njihet ndryshe edhe si K.K.

126. Shtetasi E.K *alias* K.K, nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS rezultoi i dënuar për kryerjen e disa veprave penale.

127. Komisioni ka kryer hetim shtesë duke verifikuar udhëtimet jashtë vendit të subjektit dhe bashkëshortit, bazuar në të dhënat e administruara nga Drejtoria e Policisë, të dhënat e sistemit TIMS, si dhe në të dhënat për automjetet e gjeneruara nga sistemi i AMF-së.

128. Nga analizimi i të dhënave të udhëtimeve të subjektit dhe bashkëshortit, si dhe të shtetasve E.K.K dhe T.K, nuk rezultuan që subjekti të kishte udhëtuar me këta shtetas.

129. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit⁴⁷ rezultoi se:

i. Referuar certifikatës elektronike të gjendjes gjyqësore shtetasi E.K rezultoi se është i dënuar. Sipas shkresës me nr. ***prot., datë 30.11.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, rezulton se me vendimin nr. ***, datë 16.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shtetasi E.K është deklaruar fajtor për veprën penale “goditje për shkak të detyrës”, të parashikuar nga neni 235/7 i Kodit Penal (bashkëlidhur

⁴⁶Në shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2022, është dërguar raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin, me nr. ***, datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 23.9.2022, të KDZH-së.

⁴⁷Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me *email*-in e datës 24.11.2022 dhe shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2022.

dokumentacionit të depozituar ndodhet kopja e certifikatës elektronike të gjendjes gjyqësore të shtetasit E.K dhe kopja e njehsuar e vendimit nr. ***, datë 16.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan).

ii. Për sa i përket statusit aktual të çështjeve të shtetasit E.K pranë Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, rezulton se me shkresën nr. *** prot., datë 30.11.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është dërguar informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me shtetasin E.K, nga ku rezulton si vijon:

Në datën 30.3.2015 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, i cili është bashkuar me procedimin penal nr. *** të vitit 2018.

Në qershor të vitit 2020 ky procedim penal është dërguar për gjykim në ngarkim të të pandehurit E.K, për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe me vendimin nr. ***, datë 24.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i pandehuri është deklaruar fajtor për këtë vepër penale.

130. Me vendimin nr. ***, datë 15.9.2021, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur ndryshimin e vendimit datë 24.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke e deklaruar të pafajshëm të pandehurin E.K, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (bashkëlidhur kopje e njehsuar e këtij vendimi).

131. Në datën 22.11.2019, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale “goditje për shkak të detyrës”, të parashikuar nga neni 237/5 i Kodit Penal, procedim i cili është dërguar për gjykim në qershor të vitit 2020 në ngarkim të të pandehurit E.K.

132. Me vendimin nr. ***, datë 16.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shtetasi E.K është deklaruar fajtor për veprën penale “goditje për shkak të detyrës”, të parashikuar nga neni 235/7 i Kodit Penal.

133. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është përcjellë shkresa nr. *** prot., datë 18.10.2018, e Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë, që ka të bëjë me arrestimin në datën 17.10.2018 të shtetasit E.K *alias* K.K, mbi bazën e kërkesës së ardhur nga autoritetet italiane të drejtësisë, me objekt “njohje vendimi penal të huaj” lidhur me këtë shtetas. Ky shtetas është shpallur në kërkim ndërkombëtar me urdhrin datë 11.9.2018 të Prokurorisë Publike të Pescarës Itali, për ekzekutimin e një dënimi për të cilin është nxjerrë urdhërekzekutimi në datën 5.11.2011. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 26.12.2018, ka vendosur: *Pranimin e kërkesës për njohjen e vendimit penal të huaj nr. ***, datë 19.5.2011, të gjyqtarit të hetimeve paraprahe të Gjykatës së Peskarës Itali, i cili ka marrë formë të prerë në datën 1.10.2011, për shtetasin E.K alias K.K, për veprat penale:*

- “*mashttrim*”, “*mashtrimi në sigurime*”, “*prodhim dhe shitje e narkotikëve*”, “*kallëzim i rremë*”, “*grup i strukturuar kriminal*”;
- *në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal është vendosur bashkimi i dënimeve dhe njohja si dënim përfundimtar për të dënuarin E.K alias K. K, me 4 vjet e 8 muaj;*
- *mosekzekutimi i këtij vendimi për të gjitha detyrimet për shkak të kalimit të afateve të parashkrimit;*
- *shuarja e masës së sigurimit “arrest në burg”, për të arrestuarin E.K alias K.K (bashkëlidhur është depozituar kopje e njehsuar e vendimit dhe e praktikës së ekzekutimit).*

Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 10.2.2019.

134. Në datën 19.3.2020, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është regjistruar procedimi pasuror nr. **, i cili vijon të jetë në fazën e hetimit.

135. Nga hetimi i Komisionit, në rrethet ku subjekti ka ushtruar detyrën e prokurores, ka rezultuar se ndaj shtetasit E.K nuk ka pasur apo të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

136. E pyetur për marrëdhënien me këtë shtetas, subjekti ka shpjeguar⁴⁸ se: “*Me shtetasin E. K nuk ka marrëdhënie të asnjë lloji. Në vitin 2015 bashkëshorti është interesuar dhe ka kërkuar në pika të ndryshme të tregtimit të automjeteve në Elbasan, të cilat ndodhen përgjatë rrugës Elbasan-Metalurgji (fshati Katund i Ri) dhe në njërën nga këto pika ka parë një automjet tip ‘Golf’, i cili ishte në shitje. Pasi ka parë të dhënat e automjetit dhe çmimin që ndodhej në xhamin e tij, duke vlerësuar se i përshtateshin kërkesave dhe mundësive financiare, ka kontaktuar me pronarin e pikës së tregtimit, prej të cilit ka mësuar se automjeti ishte në pronësi të një personi, i cili e kishte lënë për ta shitur. Ai ishte i pajisur me prokurë dhe shitja mund të kryhej në çdo moment. Në datën 4.6.2015 është disbursuar kredia e marrë pranë ‘Credins Bank’ për blerjen e automjetit dhe në të njëjtën ditë është paguar çmimi për blerjen e tij dhe është lidhur kontrata e shitblerjes. Unë jam paraqitur në zyrën e noterit dhe aty i pranishëm ka qenë edhe përfaqësuesi me prokurë i shitësit, i cili është identifikuar nga noteri. Të dy kemi nënshkruar kontratën e përgatitur paraprakisht nga noteri dhe jemi larguar nga zyra brenda pak minutash”.*

137. Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se as nuk e njihnte personalisht shtetasin E.K dhe as është interesuar për të mësuar ndonjë të dhënë për këtë shtetas, pasi ishte thjesht një tregtar automjete, i cili shiste automjete dhe ishte pajisur me prokurë përfaqësimi nga pronari i automjetit për ta shitur atë dhe ajo ka paguar vlerën e tij.

138. Subjekti ka depozituar ekstrakti historik të QKB-së për subjektin tregtar në emër të “E.K”, person fizik, me NIPT ***P, me datë regjistrimi 8.7.2014, me objekt veprimtarie “tregti me pakicë automjete dhe servis etj.”, me vendndodhje në fshatin Katund i Ri, Elbasan.

139. Subjekti ka shpjeguar se: “*Në lidhje me kontratat e qirasë të lidhura midis bashkëshortit tim A.B dhe shtetasit T. K sqaroj se në fillim të vitit 2018 bashkëshorti im*

⁴⁸Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me email-in e datës 24.11.2022 dhe shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2022.

është interesuar në disa zyra imobiliare në qytetin e Elbasanit dhe Tiranës për të gjetur një apartament me qira në Tiranë. Në një nga këto zyra i është ofruar, ndër të tjera, edhe një apartament në pronësi të shtetasit T.K. Ky i fundit është kontaktuar nga zyra imobiliare, pasi nuk kishim asnjë njohje me të dhe pasi është rënë dakord për çmimin, në muajin mars 2018 është lidhur kontrata e qirasë me afat deri në datën 30.9.2019 dhe në datën 9.10.2019 është lidhur kontrata e qirasë nr. ***. Kjo kontratë është revokuar me deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.4.2020.

140. Kontratat e qirasë janë nënshkruar nga shtetasi T.K (babai i E. K.), i cili është prezantuar si pronari i banesës dhe me të drejta të plota për të lidhur kontratën e qirasë. Pagesat e qirasë për të gjithë periudhën 1.3.2018 – 13.4.2020 janë kryer rregullisht nga bashkëshorti im A.B tek qiradhënësi T.K. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratave të qirasë të gjitha komunikimet dhe pagesat janë kryer me shtetasin T.K. Në asnjë rast nuk është komunikuar apo takuar me bashkëpronarin tjetër të kësaj pasurie, shtetasin K. K.

141. Unë nuk kam pasur dijeni se shtetasi K.K, bashkëpronari i apartamentit, të njihej edhe me emrin E.K dhe aq më pak që ai ishte i njëjti person i cili kishte qenë përfaqësuesi me prokurë i pronarit të automjetit të cilin unë kisha blerë 3 vjet më parë, në vitin 2015”.

142. E pyetur nga Komisioni, nëse ka pasur dijeni mbi dënimin e shtetasit E.K alias K.K nga autoritetet italiane për prodhim dhe shitje të narkotikëve, kallëzim të rremë, grup i strukturuar kriminal, etj., subjekti ka shpjeguar se: “Nuk ka pasur ndonjëherë dijeni që shtetasi E.K të jetë dënuar penalisht nga autoritetet italiane për pjesëmarrje në organizatë kriminale, trafik narkotikësh etj. Për statusin e tij gjyqësor dhe aktual në Shqipëri dhe dënimin e tij në vitin 2011 nga gjykata italiane, deklaroj me përgjegjësi të plotë se jam vënë në dijeni vetëm këto ditë dhe për shkak të pyetësorit dërguar nga Komisioni.

Në kushtet kur unë nuk kam pasur njohje, kontakt apo marrëdhënie të ndonjë lloji me këtë shtetas, nuk kam pasur as mundësi dhe as interes për të marrë një informacion të tillë. Në funksion të bashkëpunimit tim maksimal për të siguruar dhe për të vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin provues që më është kërkuar, kam rënë në dijeni të vendimeve gjyqësore për këtë shtetas.

Sipas vendimit nr. ***, datë 26.12.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ka pranuar kërkesën për njohjen e vendimit penal të huaj nr. ***, datë 19.5.2011, të gjyqtarit të hetimeve paraprake të Gjykatës së Pescarës Itali, rezulton se shtetasi E.K alias K.K është dënuar për veprat penale ‘mashtrim’, ‘mashtrim në sigurime’, ‘prodhim dhe shitje e narkotikëve’, ‘kallëzim i rremë’, ‘grup i strukturuar kriminal’.

Ashtu sikurse rezulton edhe nga vendimi gjyqësor i mësipërm, edhe vetë autoritetet shqiptare janë vënë në dijeni të dënimin penal të shtetasit E.K alias K.K në tetor të vitit 2018, pra 3 vjet pas blerjes së automjetit nga ana ime dhe disa muaj pas lidhjes së kontratës së qirasë.

Hera e parë dhe e fundit e kontaktit me shtetasin E.K ka qenë vetëm në datën 4.6.2015 për pak minuta në zyrën e noterit ku unë kam nënshkruar kontratën për blerjen e automjetit

dhe ky shtetas ka nënshkruar në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të pronarit të automjetit, thjesht si pronar i një pike tregtimi automjetesh i gjetur në mënyrë rastësore.

Gjithashtu, për periudhën mars 2018 – 2019 – prill 2020, periudhë në të cilën kanë vijuar kontratat e qirasë të lidhura me shtetasin T.K, familja jonë jetonte në Tiranë, ndërsa unë punoja në qytetin e Fierit. Për shkak të largësisë së vendit të banimit dhe vendit të punës, ngarkesës së madhe në punë dhe angazhimeve në familje (me një fëmijë 1 vjeç) kam qenë plotësisht e fokusuar dhe tejet e ngarkuar me jetën time familjare dhe profesionale dhe aspak e interesuar për të ndjekur mediat online apo se çfarë ndodhte me jetën e njerëzve të tjerë me të cilët nuk kisha as njohje, as kontakte dhe asnjë lloj marrëdhënieje”.

143. Komisioni i ka kërkuar subjektit informacion dhe dokumentacion nëse gjatë ushtrimit të detyrës së OPGJ-së apo prokurores ka qenë ndonjëherë e përfshirë në hetime të prokurorisë në lidhje me shtetasin E.K.

144. Subjekti ka shpjeguar se gjatë ushtrimit të detyrës nga ana ime si OPGJ pranë Prokurorisë së Rrethit Elbasan (nga muaji prill 2000 deri në datën 1 qershor 2015) apo si prokurore në prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore Fier, Durrës dhe Lushnjë nuk është përfshirë në asnjë rast në hetime në lidhje me shtetasin E.K.

145. Për të provuar këtë pretendim, subjekti ka depozituar dokumentacionin vijues:

- Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan⁴⁹, ku referohet se nga verifikimi nuk rezulton se gjatë ushtrimit të detyrës si OPGJ znj. Beluli të jetë ngarkuar me hetimet e procedimeve të cituar në shkresë për shtetasit E.K dhe T.K;
- Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier⁵⁰, ku referohet se nuk ka dhe nuk ka pasur të regjistruar procedim penal në ngarkim të shtetasve E.K *alias* K.K;
- Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë⁵¹, ku referohet se nuk ka dhe nuk ka pasur të regjistruar procedim penal në ngarkim të shtetasve E.K *alias* K.K;
- Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës⁵², ku referohet se në ngarkim të shtetasit E.K ka qenë regjistruar një procedim penal për veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, për të cilën nga ana e prokurorit është kërkuar pushimi i procedimit penal dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 25.10.2021, ka vendosur pushimin e procedimit. Gjithashtu Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës konfirmon se subjekti Suela Beluli nuk ka trajtuar apo hetuar asnjë material që i përket shtetasit E.K.

146. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se, shtetasi E.K *alias* K.K është dënuar sipas vendimit penal të huaj të datës 19.5.2011, të Gjykatës së Pescarës Itali, i cili ka marrë formë të prerë në datën 1.10.2011, për veprat penale “mashttrim”, “mashttrim në sigurime”, “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, “kallëzim i rremë” dhe “grup i strukturuar kriminal”.

⁴⁹Shkresë nr. *** prot., datë 30.11.2022.

⁵⁰Shkresë nr. ** prot., datë 25.11.2022.

⁵¹Shkresë nr. *** prot., datë 25.11.2022.

⁵²Shkresë nr. *** prot., datë 30.11.2022.

147. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 26.12.2018, ka vendosur: Pranimin e kërkesës për njohjen e vendimit penal të huaj nr. ***, datë 19.5.2011, të gjyqtarit të hetimeve paraprake të Gjykatës së Pescarës Itali, i cili ka marrë formë të prerë në datën 1.10.2011, për shtetasin E.K alias K.K, për veprat penale “mashttrim”, “mashttrim në sigurime”, prodhim dhe shitje e narkotikëve, kallëzim i remë, grup i strukturuar kriminal;

- në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal është vendosur bashkimi i dënimeve dhe njohja si dënim përfundimtar për të dënuarin E.K alias K.K, me 4 vjet e 8 muaj;
- mosekzekutimi i këtij vendimi për të gjitha detyrimet për shkak të kalimit të afateve të parashkrimit;
- shuarja e masës së sigurimit “arrest në burg” për të arrestuarin E.K alias K.K. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 10.2.2019.

Analiza mbi fakte e rrethana të dala gjatë hetimit administrativ

148. Subjekti i rivlerësimit Suela Beluli ka pasur një kontakt me shtetasin E.K në vitin 2015, kur ka nënshkruar kontratën për blerjen e automjetit, pasi ky shtetas ishte përfaqësues me prokurë i pronarit të automjetit A.O.

149. Referuar dokumentacionit të administruar, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë rezultuar me një tjetër marrëdhënie me familjen K, marrjen me qira të një pjese të apartamentit në Tiranë në pronësi të shtetasve T dhe K.K (E.K) gjatë periudhës 2018 – 2020 dhe pjesa tjetër e apartamentit është e disponueshme nga pronarët. Ky apartament i përdorur nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës si prokurore, si dhe gjithë pasuria e familjes K, burimet e krijimit të tyre janë bërë objekt i një hetimi pasuror nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Konstatimi i Komisionit

150. Për sa ka rezultuar nga hetimi, kontaktet e subjektit me këtë shtetas duken si kontakte jo të rastësishme, por marrëdhënie në vijimësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me shtetasin E. K., i cili, referuar provave të administruara, ka rezultuar i dënuar me vendim të formës së prerë për disa vepra penale, si “prodhim e shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, “grup i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a i Kodit Penal, “mashttrim në sigurime” etj.

151. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi, Komisioni ngriti dyshime se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

152. Për faktet e rezultuara gjatë hetimit subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

153. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka shpjeguar se,

i. Referuar gjetjeve të Komisionit në lidhje me shtetasin E.K, subjekti i rivlerësimit, në prapësime ka paraqitur të njëjtat pretendime dhe ka rikonfirmuar se ajo dhe bashkëshorti i saj nuk ka pasur asnjë njohje me këtë shtetas. Subjekti ka pretenduar se takimi ka qenë tërësisht i rastësishëm dhe aq më pak i paparashikueshëm prej saj, pasi nuk ka pasur dijeni që pronari i automjetit nuk do të paraqitej vetë para noterit e aq më pak të sillte një person, i cili rezultonte të ishte me precedentë penalë.

ii. Në lidhje me marrjen e shtëpisë me qira, subjekti ka shpjeguar se vajza e saj ka lindur premature dhe e kanë shoqëruar disa probleme shëndetësore. Për pasojë u lindi nevoja që të ishin pranë një spitali në qytetin e Tiranës për shërbime më të specializuara. Në vijim, në vitin 2017, kur ushtronte funksionin në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier dhe rruga vajtje - ardhje në kushtet kur vajza ishte mjaft e vogël dhe me probleme shëndetësore, do të ishte më e lehtë për subjektin të udhëtonte nga Tirana për në Fier, pasi nga ky qytet kishte edhe kolegë të tjerë që udhëtonin. Në këtë mënyrë lodhjen dhe shpenzimet do t'i ndante me kolegët.

Për arsyet e mësipërme, në fillim të vitit 2018, bashkëshorti i subjektit është interesuar në disa zyra imobiliare në qytetin e Elbasanit dhe Tiranës për të gjetur një apartament me qira në Tiranë me një çmim të arsyeshëm dhe të përballueshëm. Në zyrën imobiliare të shtetasi A.M i është ofruar një apartament në pronësi të shtetasit T.K. Ky i fundit është kontaktuar nga zyra imobiliare, pasi nuk kishin asnjë njohje apo kontakt me të dhe pasi është rënë dakord për çmimin, në muajin mars 2018, është lidhur kontrata e qirasë me afat deri në datën 30.9.2019. Në datën 9.10.2019 është lidhur kontrata e qirasë nr. ***. Kjo kontratë është revokuar me deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.4.2020.

Fakti se apartamenti është gjetur nga zyra imobiliare provohet nga aktmarrëveshja datë 20.1.2018, lidhur midis bashkëshortit A.B dhe "A.M", person fizik, me NIPT K***M, me vendndodhje në Elbasan, sipas së cilës është rënë dakord për ofrimin e shërbimit të gjetjes së apartamentit kundrejt pagesës prej një qiraje mujore. Kjo provë është depozituar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

Kontratat e qirasë janë nënshkruar nga bashkëshorti A.B dhe nga shtetasi T.K, i cili është prezantuar si pronari i banesës dhe me të drejta të plota për të lidhur kontratën e qirasë. Në asnjë rast nuk është komunikuar apo kontaktuar me bashkëpronarin tjetër të kësaj pasurie, shtetasin K.K, pasi me këtë shtetas nuk kishin as njohje dhe as marrëdhënie. Në kontratën e qirasë është rënë dakord që do të përdoret një dhomë, një kuzhinë gatimi, një tualet dhe një korridor. Pjesa tjetër e banesës (dhoma dhe një tualet) nuk janë përdorur as nga familja e subjektit dhe as nga pronari, pasi shërbenin si magazinë. Në asnjë rast qiradhënësi me të cilin ishte lidhur kontrata, dhe aq më pak bashkëpronari tjetër, nuk kanë shkuar në banesë për asnjë arsye dhe nuk kishin asnjë mundësi akses në të, pasi çelësin e banesës e dispononte vetëm subjekti me bashkëshortin (i vjetri ishte ndërruar për shkaqe sigurie).

Subjekti ka konfirmuar se as ajo dhe as bashkëshorti i saj nuk kanë pasur njohje apo marrëdhënie me bashkëpronarin tjetër të kësaj pasurie, i cili në dokumentin e pronësisë kishte emrin K.K, se cila ishte marrëdhënia e tij me bashkëpronarin dhe aq më pak të

merrnim me mend se ishte i njëjti person që kishte përfaqësuar me prokurë 3 vjet më parë shitësin e automjetit ku ai ishte identifikuar nga noteri me emrin E.K.

Kur kontrata e qirasë ishte nënshkruar vetëm me shtetasin T.K nuk kishin asnjë dijeni, asnjë mundësi për të rënë në dijeni dhe asnjë lloj interesi për të marrë dijeni në lidhje me gjendjen gjyqësore të shtetasit K.K. Hera e parë dhe e fundit e kontaktit të subjektit me shtetasin E.K ka qenë vetëm në datën 4.6.2015, për pak minuta në zyrën e noterit, ku ka nënshkruar kontratën për blerjen e automjetit dhe ky shtetas ka nënshkruar në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të pronarit të automjetit thjesht si pronar i një pike tregtimi automjetesh i gjetur në mënyrë rastësore.

iii. Subjekti gjithashtu ka shpjeguar se bazuar në kërkesat ligjore të sanksionuara në nenin 38 të ligjit, pika 4, rezulton se:

Së pari, nuk evidentohet asnjë e dhënë, *indicie* për ekzistencën qoftë edhe vetëm të një informacioni për lidhjen e saj me shtetasin E.K, e pasqyruar në formën e fotografisë apo e dhënë e treguar nga një dëshmitar.

Së dyti, subjekti personalisht nuk ka pasur asnjë lloj komunikimi me shtetasin E.K, ndërsa komunikimi i bashkëshortit me të ka qenë rastësor, vetëm në blerjen e automjetit.

Së treti, marrëdhënia me shtetasin E.K ka qenë vetëm kontraktuale, rastësore. Në funksion të këtij përfundimi vijnë rezultatet e arritura në saj të kësaj marrëdhënieje, blerja e automjetit me çmimin e tregut dhe pa asnjë lloj trajtimi preferencial si në çmimin e shitjes ashtu edhe në shlyerjen e tij, i cili është bërë menjëherë dhe jo e ndarë në këste. Nga rezultatet e kësaj marrëdhënieje kontraktuale del qartë marrëdhënia e subjektit me këtë shtetas, ku nuk ekziston as minimumi i trajtimit preferencial.

Së katërti, nuk ka përfituar dhe as ka shkëmbyer ndonjë të mirë materiale të çfarëdolloji me këtë shtetas.

Së pesti, lidhja e subjektit me këtë shtetas është rastësore dhe aspak e ngushtë, e cila rezulton qartësisht nga më sipër u parashtrua.

Së gjashti, si nga hetimi i kryer nga Komisionit, nga DSIK-ja në kuadër të procesit të rivlerësimit, ashtu edhe nga kjo e fundit për lëshimin e certifikatës së sigurisë, nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që subjekti të ketë bërë takime me këtë person apo me persona të tjerë.

iv. Nisur sa më sipër, subjekti ka kërkuar që në vlerësimin final të Komisionit për kriterin e figurës duhet ta trajtojë kontaktin kontraktual me shtetasin E.K si një kontakt rastësor.

Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se në zbatim të germës “a” të nenit 35/5, ka parashtruar në mënyrë të besueshme se nuk ka qenë në dijeni të faktit se shtetasi E.K ka qenë i dënuar.

Si e tillë, subjekti ka kërkuar nga Komisioni të reflektojë gjetjen e tij nën dritën e rrethanave lehtësuese dhe të gjitha provave dhe shpjegimeve të dhëna prej saj. Këto të fundit, nën dritën edhe të provave të grumbulluara nga Komisioni gjatë procesit

administrativ, pasqyrojnë qartë marrëdhënien e subjektit me shtetasin E.K si rastësore, pa asnjë lloj përftrimi material dhe as trajtim preferencial.

154. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mbështetje të shpjegimeve të saj ka depozituar akte⁵³ provuese, të cilat janë analizuar nga Komisioni.

Vlerësimi i Komisionit

155. Trupi gjykues, pas depozitimit nga subjekti të prapësimeve, në analizim të situatës objekt gjykimi, ka evidentuar disa rrethana të cilat duhen të konsiderohen në vlerësimin përfundimtar të kriterit të figurës, si vijon:

i. Pronari i automjetit rezulton të ishte shtetasi A.O, i cili në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes 4.6.2015 rezultoi që nuk ishte brenda vendit. Sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS ka rezultuar se pronari i automjetit A.O ka dalë jashtë Shqipërisë në datën 3.6.2015, ora 21:41 dhe ka hyrë në datën 12.6.2015. Shtetasi E.K, në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së automjetit tip “Volkswagen Golf”, 4.6.2015, rezulton të ketë qenë në Shqipëri.

Në këto kushte, ky shtetas ka lëshuar një prokurë të posaçme që shtetasi E.K të kryente veprimet e nevojshme për shitjen e këtij automjeti.

Nga këto rrethana rezulton e provuar se takimi që subjekti ka pasur me këtë shtetas ka qenë i rastësishëm dhe në të njëjtën kohë i paparashikuar prej saj, pasi subjekti nuk ka pasur dijeni se kush do të ishte përfaqësuesi me prokurë i pronarit të automjetit.

ii. Sikurse e deklaroi edhe subjekti, shtetasi E.K deri në datën kur është shpallur vendimi nr. ***, datë 26.12.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kur u pranua kërkesa për njohjen e vendimit penal të huaj të Gjykatës së Pescarës Itali, e cila e dënonte shtetasin E.K *alias* K.K për vepra penale në fushën e trafikut dhe krimit të organizuar, nuk rezultonte në Shqipëri i dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në pikën 15 të neni 3 të ligjit nr. 84/2016.

Për pasojë, subjekti nuk ka pasur dijeni në lidhje me dënimin e këtij personi apo me aktivitetin kriminal të tij në fushën e krimit të organizuar dhe trafikimit të lëndëve narkotike, megjithëse ai ishte i proceduar dhe i dënuar disa herë në Shqipëri për vepra të tjera penale.

⁵³Aktet si vijon: (i) dokumente shëndetësore për vajzën A; (ii) aktmarrëveshje datë 20.1.2018, me palë A.B dhe A.M për gjetjen e një apartamenti me qira në Tiranë (1 fletë); (iii) dokument datë 1.3.2018, nënshkruar nga shtetasit A.B dhe A. M, bashkëlidhur mandati nr. **, datë 1.3.2018, në shumën 20.000 lekë, i zyrës imobiliare A.M (2 fletë); (iv) certifikatë regjistrimi për personin fizik “A.M” (1 fletë); (v) kërkesë drejtuar kompanisë O dhe konfirmimi postar për dërgimin e saj (2 fletë); (vi) kërkesë drejtuar kompanisë O nga shtetasi A.B (1 fletë); (vii) komunikim me *email* me kompaninë “O”, për dërgimin e të dhënave për numrin *** (1 fletë); (viii) të dhënat mbi thirrjet dhe *sms* të kryera nga numri ***, për periudhën 10.10.2020 deri në datën 15.1.2023 (41 fletë); kërkesë drejtuar V në emër të znj. Suela Beluli, (2 fletë); (ix) komunikimet me *email* me kompaninë V (4 fletë); (x) shkresë nr. B.D/***, datë 19.1.2023, e kompanisë V dhe të dhënat bashkëlidhur kësaj shkrese (66 fletë); (xi) kopje e shkresës nr. *** prot., datë 4.8.2022, dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier për dërgimin e certifikatës së sigurimit nr. S-***, lëshuar në datën 21.7.2022 (2 fletë).

Në këto kushte, kur kontakti i vetëm i subjektit ka qenë në vitin 2015 dhe njohja e vendimit të huaj ishte bërë më 26.12.2018, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, në përgjigje të pyetjes të germave “c” dhe “e” të pjesës nr. 5 të shtojcës 3, “Të dhëna për sigurinë”, të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka pasur dijeni se personi i cili ka përfaqësuar me prokurë shitësin e automjetit ishte person i përfshirë në krimin e organizuar në Itali dhe i dënuar, rrethanë e cila klasifikohet sipas nenit 38/5/a të ligjit nr. 84/2016.

iii. Në lidhje me përdorimin e apartamentit të marrë me qira nga subjekti me familjen K, nga aktet e depozituara nga subjekti në prapësime pretendohet se bashkëshorti i subjektit ka kontaktuar me një zyrë pasurish të paluajtshme në pronësi të shtetasit A.M, i cili i ka ofruar një apartament në Tiranë, në pronësi të shtetasit T.K. Subjekti shpjegoi se ky i fundit është kontaktuar nga zyra imobiliare, pasi nuk kishin njohje apo kontakt me të dhe pasi është rënë dakord për çmimin, në mars të vitit 2018 është lidhur kontrata e qirasë.

Subjekti ka shpjeguar se fakti që apartamenti është gjetur nga zyra imobiliare provohet nga aktmarrëveshja e datës 20.1.2018, lidhur midis bashkëshortit të saj dhe “A.M”, person fizik, me NIPT K***M, me vendndodhje në Elbasan, sipas së cilës është rënë dakord për ofrimin e shërbimit të gjetjes së apartamentit kundrejt pagesës prej një qiraje mujore.

Në vijim, Komisioni arsyeton se e gjithë marrëdhënia e qiramarrjes, kontratat e qirasë dhe deklaratat noteriale për revokimin e tyre janë nënshkruar nga bashkëshorti i subjektit dhe shtetasi T.K (babai i shtetasit E.K). Certifikata e pronësisë së apartamentit në përdorim të subjektit rezulton në emër të dy shtetasve T.K dhe K.K. Pra, megjithëse subjekti me bashkëshortin kanë përdorur një pasuri në pronësi të shtetasit E.K, nuk u provua nga Komisioni se subjekti ka pasur kontakte personale në vijimësi me shtetasin E.K *alias* K. K.

156. Për sa më sipër, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e dala nga hetimi i çështjes, në shpjegimet dhe provat e depozituara në prapësime, bazuar edhe në të dhënat e administruara nga autoritetet përgjegjëse për kontrollin e figurës, për një vlerësim sa më objektiv të çështjes, Komisioni çmon se nuk disponohen elemente të mjaftueshme provueshmërie për të përmbushur rrethanat e parashikuara në pikën 4 (rrethana këto që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar) në përputhje me standardet e kontrollit të figurës, sipas nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi i Komisionit mbi kontrollin e figurës

157. Përfundimisht, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit Suela Beluli ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi nga vlerësimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të dala gjatë hetimit administrativ, të të gjitha provave dhe shpjegimeve të dhëna nga vetë subjekti në prapësime, tregojnë qartë një marrëdhënie rastësore të subjektit me personin e përfshirë në krimin e organizuar. Gjithashtu, subjekti ka plotësuar saktë deklaratën për kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

158. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit⁵⁴ të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

159. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;
- pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- të dhënave nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe sektori i protokoll-arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme.

160. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet si vijon:

i. Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit

Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Subjekti i rivlerësimit Suela Beluli është emëruar në detyrën e prokurorit në datën 4.6.2015 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku vijon edhe aktualisht.

ii. Analizimi i dosjeve të vëzhguara

Nga tri dokumentet e depozituara nga subjekti dhe pesë dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short, nuk u konstatuan problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional të subjektit Suela Beluli, në cilësinë e prokurores së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

iii. Të dhënat nga burime arkivore të KLP-së

Nga verifikimi i të dhënave në arkivin e KLP-së nuk rezulton që prokurorja Suela Beluli të ketë marrë masa disiplinore.

Nga Prokuroria e Përgjithshme janë administruar vlerësimet e Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin Suela Beluli, që i përkasin punës së saj për vitet 2015 dhe 2016, nga ku rezulton se për punën e saj gjatë kësaj periudhe është vlerësuar “shumë mirë”.

ANALIZA E GJETJEVE⁵⁵

⁵⁴Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2022.

⁵⁵Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

161. Nga shqyrtimi i akteve të depozituar nga subjekti, si dhe pesë dosjeve penale të shortuara, nga ana e Grupit të Punës të KLP-së nuk janë evidentuar problematika për të ndikuar në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit. Nga analizimi i këtyre akteve dhe nga ana e Komisionit nuk rezultuan të dhëna apo *indicie* për veprime hetimore të subjektit apo vendimmarrje të saj jo në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016.

162. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e akteve të dosjes rezulton se prokurorja Suela Beluli, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit.

Prokurorja Suela Beluli shfaq aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Ajo përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret. Subjekti ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale. Ajo shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Prokurorja konstatohet se ka njohje edhe me ligjet përkatëse të fushave të caktuara sipas procedimeve penale që ka trajtuar.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e akteve dhe e dosjeve gjyqësore të shortuara evidentohet se subjekti i rivlerësimit Suela Beluli shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej saj kanë shtjellim të kuptueshëm. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e saj të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur gjatë arsytimit.

Në arsyetimet ligjore prokurorja bën analizë të normave të ligjeve përkatëse, Kodit Penal dhe Procedurës Penale.

163. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave rezulton se për periudhën e punës prokurorja ka trajtuar 203 çështje.

Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura me short rezulton se nga ana e prokurores Suela Beluli tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Në analizë të akteve të shqyrtuara konstatohet se subjekti Suela Beluli ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe numrit total në çështjeve të përfunduara për të gjithë periudhën e vlerësimit.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Prokurorja Suela Beluli kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat

në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve.

Gjithashtu vihet re se qëndrimi i prokurores në seancë gjyqësore, është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurorja ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

164. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë prokurorja, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nuk rezulton të ketë pasur ankesa se nga ana subjektit të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla jo në përputhje me etikën profesionale të prokurores.

Në lidhje me etikën në punë dhe ndonjë konflikt të mundshëm interesi, Komisioni ka hetuar edhe për shtetasit që kanë marrë me qira nga subjekti “njësinë me sip. 36.7 m²” në qytetin e Elbasanit, në pronësi të subjektit.

Përfundimisht, nga hetimi i kryer nuk rezultuan problematika që do cenonin kriterin e etikës në punë.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Suela Beluli dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga aktet e vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë nga aktet e dosjet e vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Nga grupi i punës nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

165. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga aktet e vëzhguara vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Suela Beluli për vitet 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti Suela Beluli rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

Denoncime nga Publiku

166. Për subjektin e rivlerësimit Suela Beluli janë administruar 6 denoncime nga publiku, nga të cilat 2 janë të përsëritura. Për 2 denoncimet vijuese subjektit i janë kërkuar shpjegime.

1. Denoncim i shtetasit D.S

Ky denoncues ka ngritur pretendime në lidhje me subjektin e rivlerësimit Suela Beluli, pasi ka qenë prokurore në një çështje të kallëzuar prej tij pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Denoncuesi pretendon se në vitin 2003 ka porositur një apartament në vlerën 53.000 euro tek një subjekt privat dhe argumenton se megjithëse ka shlyer të gjitha detyrimet karshi subjektit ndërtues të pallatit, pas 17 vjetësh nuk ka mundur të pajiset me certifikatë pronësie, i cili ende nuk është i certifikuar nga organet kompetente për banim.

Denoncuesi ka paraqitur kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim”. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal”, me arsyetimin se faktet e kallëzuara nuk përmbanin elemente të veprës penale, si dhe nëse do kishte shkelje të ligjit nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit pranë Bashkisë Durrës është çmuar se kanë kaluar afatet e parashkrimit të veprës penale prej 10 vjetësh, pra nuk mund të ushtrohej ndjekje penale për këtë leje ndërtimi. Ky vendim ishte ankuar nga denoncuesi dhe në përfundim Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur ta kthejë çështjen për rihetim.

Në lidhje me denoncimin e këtij shtetasi, subjekti ka shpjeguar se prokurorja O.Rr (si prokurore e kësaj çështjeje), me vendimin datë 17.10.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për këtë kallëzim penal.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 5.3.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. (***) **, datë 17.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pranimin e kërkesës ankimore të kërkuarit D.S, shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës “Për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, datë 17.10.2018, dhe regjistrimin e procedimit penal për këtë kallëzim penal.

Në vijim, me ndjekjen e këtij procedimi penal është caktuar subjekti Suela Beluli⁵⁶, por me vendimin e datës 25.9.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë subjekti është rikthyer në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier dhe procedimi penal nr. *** i vitit 2019 i është caktuar një prokurori tjetër.

- ✓ Nga analiza e akteve nuk rezultuan të dhëna apo veprime të subjektit që të ndikojnë në vlerësimin profesional të saj.

2. Denoncime të shtetasit Rr.L

Denoncuesi pretendon se subjekti ka vendosur të pushojë çështjen, për të cilën nuk është njoftuar nga ana e prokurorisë. Denoncuesi ka pretenduar se pala tjetër konfliktuale me anë të mashtrimit ka ndikuar tek prokuroria që të pushojë çështjen. Ky denoncues nuk ka ndonjë pretendim konkret në lidhje me subjektin Suela Beluli, por ngre pretendime për themelin e çështjes. Subjekti ka shpjeguar⁵⁷ se në lidhje me pretendimin e denoncuesit se subjekti ka pushuar çështjen dhe nuk është njoftuar nga ana e prokurorisë vendimi i mosfillimit, shtetasi Rr.L është njoftuar për kallëzimin penal nr. *** të vitit 2018 nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2018 shtetasve A.L dhe Rr.L në banesën e tyre në fshatin L, Fier.

- ✓ Nga analiza e dokumenteve nuk rezultuan të dhëna që të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e prokurorit Suela Beluli dhe sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016 subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “e aftë”.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Suela Beluli ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e saj, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

⁵⁶Subjekti ka bashkëlidhur përgjigje të kopjes së vendimit të mosfillimit, datë 17.10.2018, të prokurores O.Rr, urdhër datë 17.4.2019, për regjistrimin e procedimit penal, të cilat i janë vënë në dispozicion me shkresën nr. ***, datë 30.11.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, akte këto të cilat sqarojnë pozicionin e subjektit në raport me pretendimet e denoncuesit D.S. Sipas shkresës së sipërcituar të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, procedimi penal nr. *** i vitit 2019 vazhdon të jetë në fazën e hetimeve dhe nuk ka një vendimmarrje.

⁵⁷Subjekti ka depozituar kopje të akteve që përmban fashikulli i kallëzimit penal nr. ***, viti 2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të vëna në dispozicion me shkresën nr. *** prot., datë 25.11.2022 të kësaj Prokurorie.

- b. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Suela Beluli, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 1.2.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Suela ZHEGU
Relatore

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha

